



KONTROLLI I PARTËTË SHIETË



# RAPORT

PER AUDITIMIN E USHTRUAR

NË

INSPEKTORATIN E LARTË TE DEKLARIMIT DHE  
KONTROLLIT TE PASURIVE DHE KONFLIKTIT TE  
INTERESAVE. TIRANE

Tirane, 2018.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

### RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

*"Mbi auditimin e llogarive vjetore të Institucionit".*

Auditimi u ushtrua në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1083/1, dt. 17.09.2018.

Auditimi është kryer nga:

1. Valentina Golemi, përgjegjës grupi;
2. Joniada Goçaj;
3. Aldo Kume;

Nëntor, 2018



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

### Pasqyra e Lëndës

Nr.	EMËRTIMI	Faqet
1	<i>Përmbledhje.</i>	3-7
2	<i>A. Auditimi i pasqyrave financiare.</i>	8-22
3	<i>B. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.</i>	22-34
4	<i>C. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit</i>	35-39
5	<i>D. Gjetjet nga auditimi, impakti te pasqyrat financiare dhe rekomandimet përkatëse.</i>	39-40
<b>ANEKSET.</b>		
	<i>Aneksi I. "Qasja dhe metodologjia e auditimit".</i>	41-41
	<i>Aneksi II. "Llojet e opinioneve të aplikuara nga KLSH".</i>	42-42
	<i>Aneksi III. "Të tjera operacione me shtetin".</i>	43-43
	<i>Aneksi IV. "Auditimi i detyrimeve".</i>	44-45
	<i>Aneksi V. "Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve".</i>	46-46
	<i>Aneksi VI. "Transaksionet e ILDKPKI".</i>	47-47



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

### **PËRMBLEDHJE**

#### **Hyrje:**

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1083/1, datë 17.09.2018, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, plotësimi i pasqyrave financiare në afat, dhënia e opinionit, për saktësinë e paraqitjes së zërave të aktivitetit dhe pasqyrave të tjera shoqëruese të bilancit.

Auditimi u krye me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së raportimit financiar të aktivitetit ekonomik të mbyllur më datë 31.12.2017.

#### **Informacion i përgjithshëm:**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka filluar funksionimin në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike".

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave vepron në bazë të Kushtetutës, të legjisllacionit shqiptar në fuqi, në veçanti në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike" i ndryshuar, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, si dhe në bazë të urdhrave, udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

"Inspektorati i Lartë" nën përgjegjësinë e Inspektorit të Përgjithshëm, administron deklarimin e pasurisë, të detyrimeve financiare, ushtron kontroll të drejtpërdrejtë, mbledh të dhëna, kryen hetime dhe kërkime administrative rreth deklarimeve të personave që mbartin detyrimin ligjor për deklarim të interesave private. ILDKPKI bashkëpunon me organet e auditimit dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik.

Rregullorja e brendshme e funksionimit i ILDKPKI-së është miratuar me Urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 1499 datë 12.9.2014, "*Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të Veprimtarisë së ILDKPKI-së*", i përditësuar dhe ndryshuar në të cilën janë përcaktuar detyrat për çdo pozicion pune.

Kompetencat e ILDKPKI-së u shtuan me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike". Konkretisht, Inspektorati i Lartë drejton dhe përmirëson politikat e parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave; ofron asistencë teknike për këshillimin dhe mbështetjen e nismave ligjore e nënligjore të ndërmarra nga institucionet publike për parandalimin e konfliktit të interesave; monitoron, kontrollon dhe vlerëson zbatimin e këtij ligji etj. (neni 41 e 42 i ligjit).

#### **Objekti i veprimtarisë së ILDKPKI-së është:**

ILDKPKI ka për mision deklarimin dhe kontrollin e interesave private nëpërmjet hetimit dhe kërkimeve administrative për vërtetësinë, saktësinë dhe legjitimitetin e burimit të krijimit të pasurive për të zgjedhurit, nëpunësit publik, për familjarët dhe personat e lidhur me ta.

Garantimin e një vendimmarrje të paanshme, transparente, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesave publike dhe atyre private të zyrtarit, në ushtrimin e funksioneve të veta, si dhe arritjen e standardeve ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit.

Hetimi i rasteve të veprimeve korruptive të paraqitura nga sinjalizuesit, si dhe garantimin e mbrojtjes së tyre nga çdo veprim hakmarrje të ndërmarrë si rrjedhojë e raportimit.

Bashkëpunimin me organet e auditimit dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për arritjen e standarteve ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik dhe sanksionimin e masave disiplinore, kundravajtjeve dhe kallëzimeve penale për zyrtarët dhe personat e lidhur me to.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

#### Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opiniononi nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

#### Objektivat e auditimit:

Objektivat specifikë të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si: përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si: ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si: transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

#### Baza Ligjore:

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

-ISSAI 1000-2999 "Udhëzues të Auditimit Financiar";

-ISSAI 1300 "Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare"

-INTOSAI GOV 9100 "Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik"; INTOSAI GOV 9110 "Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm";

-Në praktikat më të mira të fushës si: (Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC, Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve),

-Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS),

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",

-Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar,

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik".

-UMF nr. 14, datë 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre" i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

#### Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare:

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (Nëpunësi autorizues) zj. Kozeta Ndoi dhe Drejtori i Sektorit të Financës zj. Miranda Porja janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Drejtori i Institutit dhe Përgjegjësi i Sektorit të Financës janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ILDKPKI-së.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

#### Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin e pasqyrave financiare:

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar. Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (*apo në përputhje*) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm që është relevant në entitet, në mënyrë që të programonim procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

#### Baza për Opinionin

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitet tona janë përshkruar tek pjesa, Përgjegjësitet e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet, KLSH është e pavarur nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe përgjegjësitet e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë. (*Aneksi II*)

#### Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar:

Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në ILDKPKI është realizuar në mbështetje të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara edhe shoqërohen me relacion shpjegues. (*pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare*).

#### Qasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2017 ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, vlerën 2,104,978 lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. (*Aneksi I*).



## KONTROLLI I LARTË I SHTËTIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË “INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE”

### Mbi vlerësimin e riskut.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:

#### - Kontrolli i brendshëm:

Kontrolli i brendshëm në ndërmarrje ka funksionuar i plotë, duke përfshin tërë veprimtarinë e njësisë ekonomike, i cila ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësia ekonomike mund ta dijë ku mundet të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

#### - Konfirmimet nga të tretët:

Subjekti që auditohet ka të konfirmuara (*Rakorduara*) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

#### - Inventarizimi i aktiveve:

Nga ILDKPKI për vitin 2017 ka kryer kontrole për ekzistencën dhe vlerësimin e të gjitha aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktivet afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës si përcakton UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”,

#### - Transaksionet:

*Gjatë vitit 2017 dhe 8- Mujorit të vitit 2018 u konstatua se janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë dhe nisur nga ky fakt bazuar në vlerën e materialitetit të përllogaritur u filtruan: (Aneksi VI)*

- Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin 2017 në vlerën totale 9,806,817 lekë.

- Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për 8-mujorin e 2018 në vlerën totale 4,349,962 lekë.

Urdhër Shpenzimet e filtruara do auditohen në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

### Teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

#### 1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

#### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

#### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

#### 4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

#### 5. Konfirmim nga të tretët.

Subjekti që auditohet nuk ka të konfirmuara (*Rakorduar*) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

#### 6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsisive kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*

#### OPINIONI I AUDITUESIT:

##### ***Baza për opinionin:***

KLSH ka audituar veprimtarinë e Inspektoratit e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ISSAI 1700<sup>1</sup>, dhe ISSAI 1200<sup>2</sup>, si dhe në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Menaxhimi i ILDKPKI-së është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Përgjegjësia e auditimit është të shprehet në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se aktiviteti është kryer në përputhje me kuadrin rregullativ dhe se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

##### ***I. Opinion mbi auditimin e pasqyrave financiare.***

Nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, përse i takon shkallës së zbatimit nga subjekti ILDKPKI-së, të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti është paraqitur në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare, për vitin ushtrimor përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (*hyrjeve dhe daljeve*), pasqyrën e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, shënimet që shoqëronin këto pasqyra.

Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se, bilancet, deklaratat e të ardhurave, deklaratat e mbajtjes së të ardhurave, banka janë përfshirë në deklaratat financiare. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së

<sup>1</sup> Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

<sup>2</sup> Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përse i takon gjetjeve nga auditimi.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

Financave. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e opinionit të pakualifikuar për periudhën 01.01.2017-31.08.2018.

#### ***Opinionit është i pakualifikuar.***

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në statndartet e mësipërme, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet material, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Inspektoratit të lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të pasurive dhe Konfliktit të Interesave në datën 31 dhjetor 2017.

#### **A. AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE.**

Nga auditimi u konstatua se:

Mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në ILKPKJ, për vitin 2017 është bërë në përputhje me ligjin nr. 9248, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 "Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998".

- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huaj".

- Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huaj", ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 10, datë 27.02.2008.

Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Veprimet kontabël në këtë institucion janë të regjistruara me programin kompjuterike për kontabilitetin "Alpha web". Janë kontabilizuar veprimet me "Bankën", "Hyrjet dhe Daljet e magazinës", veprimet lidhur me "Pagat" dhe veprimet lidhur me shpenzimet operative dhe për investime. Të gjitha sistemimet dhe mbylljet e llogarive të regjistruara në ditarin e "Veprimeve të ndryshme", janë kryer konform dispozitave ligjore, Udhëzimit nr. 2, datë 10.01.2002 të Ministrisë së Financave dhe udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Janë bërë rakordimet e situacionit të shpenzimeve dhe të të ardhurave me Degën e Thesarit Tiranë, të cilat paraqiten në Pasqyrën Financiare me vlerën e tyre reale.

Për të arritur në hartimin e bilanci njësia shpenzuese (sektori i financës) ka punuar duke përdoruar ditarët përkatës të kontabilizimeve, si: i hyrjeve e daljeve të bankës; hyrjeve e daljeve të magazinës; hyrje e dalje të arkës (kryesisht të valutës) dhe të arkëtimit të të ardhurave në vlera të vogla, listë pagesave të punonjësve; veprimeve të ndryshme, të shoqëruar edhe me librat përkatës të nën llogarive.

#### ***1/1. Llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve***

**Në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit**, formati nr. 3/1 janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën 127,205 mijë lekë të ndara sipas zërave si (600) "Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli" në vlerën 97,441 mijë lekë ose 77 % të totalit të shpenzimeve, për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor 2017.

Llog. (601) "Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore" në vlerën 13,086 mijë lekë ose 10 % të totalit të shpenzimeve, llog. (602) "Mallra dhe shërbime të tjera" në vlerën 16,438 mijë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

lekë ose 12.9% të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2017.

Llog. (606) "Transferata për buxhete familjare e individët" në vlerën 0 lekë.

Llog. (63) "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" në vlerën 593 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve. Ky ndryshim me ndikim negativ është regjistruar në llog. 8423 "transferim për ndryshim gjendje inventari" në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit në vlerën e mësipërme.

Vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 janë si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Nr. llog.	PERSHKRIMI I SHPENZIMEVE TE USHTRIMIT	Viti Ushtrimor	Viti i mëparshëm
a	b	c	1	2
1	Klasa 6	A. SHPENZIMET SHFRYTEZIMI (I - III)	127,203,964	107,733,167
2	60	I. Shpenzime Korrente	127,204,557	108,156,042
3	600	Paga, shpërblime e te tjera personeli	97,440,531	80,206,065
4	6001	Paga, personeli i përhershëm	97,440,531	80,206,065
5	6002	Paga, personel i përkohshëm		
6	6003	Shpërblime		
7	6009	Shpenzime tjera personeli		
8	601	Kontrib. tesig. shoq. e shendet. s.	13,085,558	11,240,817
9	6010	Kontribute për sigurimet shoqërore	13,085,558	11,240,817
10	6011	Kontribute për sigurimet shendetësore		
11	602	Mallra dhe shërbime te tjera	16,438,468	15,935,680
12	6020	Materiale zyre e te përgjithshme	3,357,919	3,858,202
13	6021	Materiale dhe shërbime speciale	126,936	133,209
14	6022	Shërbime nga te trete	7,264,789	7,250,983
15	6023	Shpenzime transporti	1,384,759	1,325,060
16	6024	Shpenzime udhëtimi	1,868,134	378,819
17	6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	1,311,358	1,650,900
18	6026	Shpenzime për qiramarrje		
19	6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale		
20	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen për hua		
21	6029	Shpenzime te tjera operative	1,124,573	1,338,507
22	603	Subvencionet		
23	6030	Subvencione për diference çmimi		
24	6031	Subvencione për te nxitur punësimin		
25	6032	Subvencione për te mbuluar humbjet		
26	6033	Subvencione për sipërmarrjet individuale		
27	6039	Subvencione te tjera		
28	604	Transferime korrente të brendshme	0	235,960
29	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise		
30	6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		235,960
31	6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shendetësore		
32	6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurëse		
33	605	Transferime korrente me jashtë		



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

34	6051	Transferime Për Organizatat Ndërkombëtare		
35	6052	Transferime PërQeveritë e Huaja		
36	6053	Transferime Për institucionet jo fitimprurëse të huaja		
37	6059	Transferime Te tjera korrente me jashtë shtetit		
38	606	Transferta për buxh. familjare e individë	240,000	537,520
39	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
40	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	240,000	537,520
41	63	II. Ndryshimi i gjendjeve të inventarit (+ -)	(593)	(422,875)

-Formati nr. 3/1 "Shpenzime të ushtrimit", nga auditimi rezultoi se formulat e miratuara nga Ministria e Financave ishin zbatuar. Janë kryer veprimet përkatëse si llogaria 85 e formatit nr. 3/1 e barabartë me llog. 85 në pasiv të bilancit kontabël. Ndryshimi i gjendjes në formatin nr. 3/1 ishte e barabartë me diferencën e klasës 3 në aktiv të bilancit, si dhe llogaritë 8423 e paraqitur në formatin nr. 3/1.

Për vitin 2017, audituam dhe situatën në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit krahasuar me planin vjetor me ndryshime, ku sipas të dhënave të paraqitura në raportin e monitorimit nga ILDKPKI, paraqitet si më poshtë:

	Emërtimi	Plani vjetor 2017	Fakti vjetor 2017	% e realizimit
1	Shpenzime personeli	117,700	109,967	93.4
2	Shpenzime të tjera korrente	20,500	16,676.5	81.3
3	Shpenzime Kapitale (F.brendsh)	3,000	2,972.4	99
	<b>TOTALI</b>	<b>141,200</b>	<b>129,615.9</b>	<b>91.8</b>

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme plani i shpenzimeve të buxhetit me financim të brendshëm në total për këtë institucion për vitin 2017 është realizuar në masën 91,8% të planit vjetor. Ndërsa shpenzimet korrente janë realizuar në masën 91.6% të planit, shpenzimet për investime janë realizuar në masën 99%.

Nga auditimi u konstatua se Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme, në bazë të formatit të raportit të përcaktuar nga struktura përgjegjëse për thesarin.

Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të pasqyrës 3/1 me thesarin ku konstatohet: Vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare formati nr. 3/1 përputhen me vlerat e paraqitura në akt rakordimin me degën e thesarit Tiranë. "Mallra dhe shërbime të tjera" sipas bilancit paraqiten në vlerën 16,438,467 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 16,416,642lekë, ku diferenca prej 22,000 lekë është diferenca midis detyrimeve të institucionit ndaj operatoreve ekonomike për shërbimet e kryera nga ana e tyre për llogari të ILDKPKI, sipas kontratave të nënshkruara, por ende të pa likuiduara deri në mbylljen e bilancit të veprimtarisë të tilla si për shërbimet për energji elektrike, ujë, telefoni, etj, ku për Dhjetor 2016të cilat janë paguar në Janar 2017 në shumën prej 289,650lekë dhe detyrimet e konstatuara për Dhjetor 2017 janë në shumën prej 311,655 lekë të cilat do të paguhen me fondet buxhetore të 2018 (311,655 lekë - 289, 650 lekë).

Paga, shpërblime e të tjera personeli sipas bilancit paraqiten në vlerën 97,440,531 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 97,041,653lekë, ku diferenca prej 398,878 lekë vjen si rezultat i diferencës së pagës dhjetor 2017 me atë të dhjetor 2016.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË “INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE”

Në thesar në muajin janar të vitit 2017 kanë kaluar pagat e dhjetor 2016, ndërsa në pasqyrën 3/1 vlera e “Paga, shpërblime e të tjera personeli” është totali për periudhën Janar-Dhjetor 2017, ku vlera e pagave Dhjetor 2017 kalon në thesar në janar të 2018. E njëjti fenomen ndodh dhe me llogarinë 601 “Kontrib.te sig.shoq.e shendets”.

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

*Në lekë*

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente	127,204,556	126,623,442	581,114
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	97,440,531	97,041,653	398,878
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	13,085,558	12,925,327	160,231
602	Mallra dhe shërbime të tjera	16,438,467	16,416,462	22,005
605	Transferta korente me jashtë	0	0	0
606	Transferta për buxh. familjare e individë	240,000	240,000	0

### *Mbi auditimin e shpenzimeve për vitin 2018 (8-mujori)*

Në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit, për periudhën 01.01.2018-31.08.2018, janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara të ndara sipas zërave

Llog.(600) “Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli” në vlerën 67,089 mijë lekë ose 78% të totalit të shpenzimeve, ku janë shpenzimet për pagat e personelit të përhershëm

Llog. (601) “Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore” në vlerën 8,983 mijë lekë ose 10.5 % të totalit të shpenzimeve,

- Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

- Në drejtim të përcaktimit të strukturës organizative në funksion të objektivave të institucionit, për vitin 2017-2018 struktura organizative e ILDKPKI është miratuar nga Kuvendi i RSH me vendimin nr. 55/2014 “ Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicionit të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të interesave” të ndryshuar me vendimin nr. 48/2016. Në Strukturën Organike të ILDKPKI, sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, për periudhën objekt auditimi, pavarësisht lëvizjeve është plotësuar numri i miratuar i punonjësve.

- Për sa i përket realizimit të fondit të pagave, respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve dhe të punonjësve të tjerë, sipas kategorive të pagave nga auditimi i kryer u konstatua se, treguesit e pagave për periudhën deri me datën 31.08.2018, për PP janë si më poshtë:

*Në '000 lekë*

Nr.	Artikulli	Deri 31.08.2018		
		Plan buxhetor 8-mujor	Fakt	%
1	Fondi i pagave	70,300	67,089	95,4%
2	Sig.Shoq. 601	10,700	8,983	84%

Nga auditimi me zgjedhje i listë pagesave rezultoi se janë shoqëruar me listë prezencat në punë, të përgatitura nga sektori i personelit dhe janë nënshkruar nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, si dhe nga Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse, si dhe e vulosur nga Dega e Thesarit. Listë pagesat janë plotësuar me të gjitha rubrikat e saj për çdo punonjës duke filluar si nga emërtesa sipas strukturës, paga bazë, ditë pune etj. edhe në rubrikën e “shitesave” apo “ndaletesave”.

Llog. (602) “Mallra dhe shërbime të tjera” në vlerën 9,147 mijë lekë ose 11% të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara për periudhën deri 31.08.2018

Llog. (606) “Transferta për buxhete familjare e individët” në vlerën 309mijë lekë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË “INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE”

Vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare deri me datën 31.08.2018 përputhen me vlerat e paraqitura në akt rakordimin me degën e thesarit Tiranë.

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

*Në lekë*

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit	Pasqyra e shpenzimeve	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente	85,528,956	85,528,956	0
600	Paga, shpërbime e të tjera personeli	67,089,761	67,089,761	0
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	8,982,688	8,982,688	0
602	Mallra dhe shërbime te tjera	9,147,407	9,147,407	0
605	Transferta korente me jashtë	0	0	0
606	Transferta për buxh. familjare e individë	309,100	309,100	0

Në pasqyrën e të ardhurave të ushtrimit formati nr. 3/2 janë pasqyruar llog. 720 financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2017 (*grant*) në shumën 127,205 mijë lekë, ku financimi i prishëm nga buxheti i shtetit i vitit 2018 në vlerën 8,362 mijë lekë. Të ardhurat jo tatimore janë pasqyruar në bilanc në formatin 3/2 në vlerën 43,641 mijë lekë dhe sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Tiranë është po e njëjta vlerë.

*Në lekë*

34	71	III. TE ARDHUTRA JO TATIMORE(a+b+c)	43,640,964	24,925,320
35	710	a) Nga ndërmarrjet dhe pronësia	55,800	31,320
36	7100	- Nga ndërmarrjet. publike jo financiare		
37	7101	- Nga ndërmarrjet. publike financiare		
38	7109	- Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	55,800	31,320
39	711	b) Shërbime administ. e ardhura sekondare	43,585,164	24,894,000
40	7110	- Tarifa administrative dhe rregullatorë		
41	7111	- Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh		
42	7112	- Takse për veprime gjyqësore e noteriale		
43	7113	- Nga shitja e mallrave e shërbimeve		
44	7114	- Te ardhura nga biletat (analizat)		
45	7115	- Gjoha dhe kamatëvonesa ,sekuestrimet e zhdëmtime	43,585,164	24,894,000
46	7116	- Te ardhura nga transferimi pronës, legalizimi ndërtimeve pa leje		
47	719	c) Te tjera te ardhura jo tatimore		

Grante korente Formati 3/2:

48	72	IV. Grante Korrente (a+b)	127,204,556	108,156,042
49	720	a) Grant korrent I brendshem	127,204,556	108,156,042
50	7200	Nga I njeiti nivel Qeverisjeje	117,842,238	99,374,839
51	7201	Nga nivel e tjera Qeverisjeje		
52	7202	Nga buxheti për pagesa të posacme te ISSH		
53	7203	Nga buxheti për mbilim deficiti te ISSHe ISKSH		
54	7204	Pjesmarrje instit. Ne tatime nacionale		
55	7205	Financ. Shtese nga të ardhurat krijuara brenda sistemit		
56	7206	Financimi i prishëm nga buxheti	9,362,318	8,781,203
57	7207	Sponsorizuar nga te brente		
58	7209	Të tjera grante te brendshme		
59	721	b) Grante korrent I jashtem		
60	7210	Nga qerate e huaja		
61	7211	Nga Organizatat Ndërkombëtare		

-Formati nr. 3/2 “Të ardhurat e ushtrimit”, në përfundim të auditimit rezultoi se janë hedhur të ardhurat e shfrytëzimit, si të ardhurat jo tatimore, e përbërë nga te ardhurat nga qera,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

te ardhurat nga gjoba dhe kamatëvonesa(43,385 mijë lekë),sekuestrime e zhdëmtime (200 mijë lekë) etj. Edhe në këtë format, në përfundim të llogaritjeve nga grupi i auditimit, rezultoi se kishte gjetur zbatim formulat e miratuar nga Ministria e Financave, ku formati nr. 3/1 nuk kishte diferenca me formatin nr. 3/2. Nga grupi i auditimit nuk u konstatua diferenca të të ardhurave të pasqyrës 3/2 me thesarin.

Klasifikimi	Pershkrimi	Shuma e Arkëtuar	Derdhur ne buxhet	Në lekë
				Mbetur për tu trashëguar
7109600	Të ardhura nga qera	55,800	55,800	0
7115499	Të tjera gjoba	43,385,164	43,385,164	0
7115600	Sekuestrime dhe zhdëmtime	200,000	200,000	0
	Shuma	43,640,964	43,640,964	0

Gjithashtu u konstatua se gjatë vitit 2017 kanë dalë tituj ekzekutiv në lidhje me gjobat për shkelje të ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 " Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik" i ndryshuar, për 186 raste në shumën prej 29,160,164 lekë të cilat janë arkëtuar brenda periudhës 30 ditore, 112 raste i kanë kaluar zyrave përmbarimore të rretheve, nga të cilat 84 raste janë arkëtuar në bankë në shumën prej 14,425,000 lekë dhe 28 rastet e tjera në shumën prej 4,200,000 lekë janë të pa mbyllura deri me datën 31.12.2017.

#### Mbi auditimin e ardhurave për vitin 2018 (8 mujori)

Në pasqyrën e ardhurave, për periudhën 01.01.2018-31.08.2018, janë të pasqyruara të ardhura nga qiraja në shumën prej 46,560 lekë dhe të ardhura nga gjobat në shumën prej 22,121,561 lekë, të cilat janë bërë derdhje në buxhet.

Për tetë mujorin e 2018 kanë dalë tituj ekzekutiv në lidhje me gjobat për shkelje të ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 " Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik" i ndryshuar, për 40 raste në shumën prej 6,600,000 lekë, të cilat janë arkëtuar brenda periudhës 30 ditore, 126 raste që i kanë kaluar zyrave përmbarimore të rretheve, nga të cilat 100 raste janë arkëtuar në bankë në shumën prej 15,521,561 lekë dhe 26 rastet e tjera në shumën prej 4,200,000 lekë janë të pa mbyllura deri me datën 31.08.2018.

#### 1/2. Bilanci

- Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare

Bilanci kontabël i vitit 2017 (llogaria vjetore 2017) është përpiluar nga Drejtoria e Financës dhe si dhe konfirmuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Kopja e bilancit është dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 821, datë 26.02.2018. Nga Dega e Thesarit Tiranë është bërë edhe vulosja e bilancit dhe formateve të pasqyrave financiare si dhe është respektuar afati i dorëzimit. Bilanci kontabël është shoqëruar me pasqyrat financiare sipas formateve të miratuara nga Ministria e Financave.

Përmbledhja e llogarive vjetore për vitin 2017 dhe krahasimi me periudhat e mëparshme.

#### Aktivi i Pasqyrës Financiare për vitin 2017

Nr.llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TË AKTIVIT	2017	2016
A	AKTIVE TË QENDRUESHME	118,879,376	123,397,631
20, 230	I. Të pa trupëzuara	0	0
202	Studime dhe kërkime		
203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme		
209	Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të pa trupëzuara(-)		
21,23,24,28	II.Akt.Qendr.të Trupëzuara	118,879,376	123,397,631
212	Ndërtime e Konstruksione	87,120,407	87,120,407



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
214	Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune	13,118,406	13,118,406
215	Mjete transporti	17,774,000	17,774,000
218	Inventar ekonomik	38,342,436	35,370,048
219	Amortizimi aktiv. Qëndrueshme të trupëzuara(-)	-37,475,873	-29,985,230
231	Shpenzime proces për rritjen e AQT		
232	Shpenzime proces për transferim kapitali		
24	Aktive të demtuara		
28	Caktimet		
25,26	III. Aktivët Financiare		
25	Huadhenie e nenhuadhenie		
26	Pjesmarrja në kapitalin e vet		
B	AKTIVE QARKULLUESE	16,558,704	16,306,931
Klasa 3	I.Gjendja e Inventarit	7,176,321	7,175,728
31	Materiale	3,299,467	3,458,730
32	Objekte inventari	3,876,854	3,716,998
35	Mallra		
Klasa 4	II.Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët	9,382,383	8,781,203
409	Furnitorë(Debitorë),parapagime pagesa pjesore	20,065	
423.429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba		
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	9,362,318	8,781,203
468	Debitor të Ndryshëm		
50.59	III.Llogaritë financiare	0	350,000
512	Llogarite në banke		
520	Disponibilitete në thesar		350,000
C	Llogari të tjera aktive	12,000	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	12,000	
	TOTALI I AKTIVIT	135,450,080	139,704,562

Shuma e aktivitet të pasqyrës financiare pasqyron aktivitet e qëndrueshme, aktivitet qarkulluese kërkesat për t'u arkëtuar dhe mjete monetare në llogarinë e thesarit që i shërbejnë institucionit për zhvillimin e aktivitetit të tij.

Nga të dhënat përmbledhëse të *Aktivitet të Pasqyrës Financiare të vitit ushtrimor të vitit 2017*, rezulton se totali i aktivitet me 31.12.2017 paraqitet me vlerën 135,450,080 lekë dhe se, "Aktivitet e Qëndrueshme", zënë 88% të vlerës totale të aktivitet ndërsa, Aktivitet Qarkulluese zënë 12% të vlerës totale. Aktivitet e Qëndrueshme në krahasim me vitin 2016, janë ulur në vlerën 4,518 mijë lekë ndërsa, Aktivitet Qarkulluese janë rritur në vlerën 252 mijë lekë.

#### Auditimi i aktiveve të qëndrueshme:

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohem i se:

*Aktivitet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuar në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.*

b. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivitet e qëndrueshme;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË “INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE”

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.

#### c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve të qëndrueshme:

##### 1. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivitet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Aktivitet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivitet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

(UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar).

##### 2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në mënyrë analitike llogaritë financiare të aktivitetit të pasqyrës financiare paraqiten si më poshtë vijon:

- Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2017 në vlerën prej 87,120,407 lekë e cila referuar inventarit përbëhet nga Vlera e godinës dhe katër garazhe në pronësi të institucionit.
- Llogaria 214 “ Instalime Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në fund të vitit 2017 në vlerën prej 13,118,406 lekë dhe sipas inventarit të vitit 2017 nuk ka ndryshime nga viti paraardhës dhe përfaqëson shpenzime për blerje gjenerator, central telefonik, kondicioner etj.
- Llogaria 215 “Mjete Transporti”, paraqitet në fund të vitit 2017 në vlerën prej 17,774,000 lekë dhe përfaqëson vlerën e 3 automjeteve në dispozicion të ILDKPKI.
- Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në vlerën prej 38,342,436 lekë dhe sipas inventarit ka ndryshime pasi janë bërë hyrje me pagesë në vlerën 2,972,388 lekë,
- Llogaria 31 “Materiale”, paraqitet në vlerën 3,299,467 lekë dhe në krahasim nga viti paraardhës është në ulje për shumën 159,263 lekë.
- Ndërsa llogaria 32 “Objekte inventari”, paraqitet në vlerën prej 3,876,854 lekë më 31.12.2017 dhe përfaqëson gjendjen e materialeve kancelari nëpër zyra dhe magazinë, si foto, perde, harta, lule, dhe libra të ndryshëm të legjislacionit etj.
- Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin”, në vlerë prej 9,362,318 lekë përfaqëson paga e sigurime të personelit për tu paguar në Janar të vitit 2018. detyrimet për tu paguar për sigurimet shoqërore e shëndetësore, shpenzime për vendimet gjyqësore, pra janë shpenzime të vitit 2017 që do të paguhet në vitin 2018, si dhe Llogaria 467 “kreditore te ndryshëm”, ku janë të regjistruara detyrimet e institucionit ndaj operatoreve ekonomike për shërbimet e kryera nga ana e tyre për llogari të ILDKPKI, sipas kontratave të nënshkruara, por ende të pa likuiduara deri në mbylljen e bilancit të veprimtarisë të tilla si për shërbimet për energji elektrike, ujë, telefoni, etj. Janë burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor) që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës.
- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në shumën 12,000 lekë, kjo shumë është keq klasifikuar, pasi nuk kemi të bëjmë me një shpenzim. Vlera prej 12,000 lekë është





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

arkëtuar tepër nga një zyrë përmbarimore, e cila do të kthehet subjektin në periudhën e ardhshme buxhetore. Në mbyllje të vitit ushtrimor, debia e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" duhet të ishte pasqyruar në shumën 12,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën e mjeteve në ruajtje në kredi të llogarisë 466. Në rastin në fjalë në pasqyrën financiare nëse do të kishim të bënim me një shpenzim të periudhave të ardhshme, nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura do të të bëheshin si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse 486, "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura"; dhe
- Kreditohet llogaria përkatëse 467, "Kreditorë të ndryshëm".

Në këtë rast vlera 12,000 lekë është e ardhur e arkëtuar tepër dhe në këtë rast Njësia e cilave trashëgon të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e pasqyrës së pozicionit financiar.

#### Mbi auditimin e Pasivit

Nga auditimi u konstatua se, Pasivi i Pasqyrës Financiare është i kuadruar me Aktivin e PF.

#### *Pasivi i Pasqyrës Financiare për vitin 2017*

*Në lekë*

Nr.llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TË PASIVIT	2017	2016
<b>A</b>	<b>FONDE TË VETA</b>	<b>126,055,697</b>	<b>130,573,359</b>
101	Fonde baze	126,055,697	130,573,359
105	Grande të Brendshme kapitale		
106	Grande të Huaja kapitale		
107	Vlera e aktiveve të qendrueshme të caktuar në përdorim		
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve të qendrueshme		
12	Rezultati i mbartur		
14	Pjesëmarrje të institucionit në investime për të tretë		
<b>B</b>	<b>DETYRIME</b>		
Klasa 4	II.Detyrime afatshkurtër	9,394,383	9,131,203
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to		
42	Personeli e llogari të lidhura me to	6,076,901	5,766,534
431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa dhe sigur. shoqër.	818,850	730,339
4341	Te tjera operacione me shtetin(kreditor)	20,065	
435	Sigurime shoqërore	1,882,832	1,740,827
436	Sigurime shëndetësore	272,080	253,853
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	12,000	350,000
467	Kreditorë të ndryshëm( kreditorë për investime)	311,655	289,650
<b>C</b>	<b>LLOGARI TË TJERA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
475	Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse		
85	Rezultati i ushtrimit		
	<b>TOTALI I PASIVIT</b>	<b>135,450,080</b>	<b>139,704,562</b>

Nga të dhënat përmbledhëse të Pasivit të Pasqyrës Financiare rezultojnë se totali i pasivit me 31.12.2017, paraqitet me vlerën 138,450,080 lekë, ku, "Fondet e veta", zënë respektivisht 93% të vlerës totale të pasivit ndërsa, "Detyrimet" zënë 7%.

Llogaria 42 "Personeli dhe llogari të lidhur me to" në vlerën 6,076,901 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2017 ndërsa shuma 818,850 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2017 të cilat likuidohen në Janar të vitit 2018 me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2018.

Llogaria 435 & 436 "Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore" në vlerën 22,154,912 lekë, përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror në shumën prej 1,882,832 lekë dhe e sigurimit



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

shëndetësor në shumën 272,080 lekë të muajit Dhjetor 2017 e cila likuidohet në muajin Janar 2018 me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2018.

Llogaria 4341 "Te tjera operacione me shtetin (kreditor)" në shumën prej 20,065 lekë, e cila vjen si rezultat i kalimit dy herë të faturës së ujit në muajin Dhjetor.

Llogaria 466 "Kreditore për mjete në ruajtje" në shumën prej 12,000 lekë është vlerë e arkëtuar tepër i cila do të kthehet subjektin në periudhën e ardhshme buxhetore.

Llogaria 467 "Kreditore të ndryshëm (kreditore për investime)" në shumën prej 211,655 lekë janë të regjistruara detyrimet e institucionit ndaj operatorëve ekonomike për shërbimet e kryera nga ana e tyre për llogari të ILDKPKI, sipas kontratave të nënshkruara, por ende të pa likuiduara deri në mbylljen e bilancit të veprimtarisë të tilla si, për shërbimet për energji elektrike, ujë, telefoni, etj. Janë burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor) që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës.

- Llogaria 63 e evidentuar në formatin 3/1 është sa ndryshimi i gjendjeve të magazinës në aktiv të PF dhe diferenca është transferuar në llogarinë për transferimin e ndryshimit të gjendjeve.

#### *Rakordimet e pasqyrave të bilancit financiar:*

*Auditimi u bë me të zgjedhur për këto llogari, formate e pasqyra financiare:*

- Auditimi për barazimin e vlerës totale të Pasivit me Aktivin:

- *Totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël (formatet 1 dhe 2), në shumën 135,450,080lekë.*

Në pasiv të bilancit janë paraqitur A/I "fondet e veta" të institucionit që arrijnë në vlerën 126,055,697lekë, e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së aktivit të bilancit 135,450,080 lekë dhe grupeve B "detyrimeve" dhe C "llogari të tjera" të pasivit në vlerën 9,394,383 leke,

- *Totali në pasqyrën e shpenzimeve është i barabartë me totalin në pasqyrën e të ardhurave të funksionimit (formatet 3/1 e 3/2), në shumën 170,845,520lekë.*

Llogaria 85 "Rezultati i veprimtarisë nga funksioni" në Formatin nr. 3/1 "Shpenzime të ushtrimit" është e barabartë me llogarinë 85 "Rezultati i ushtrimit" në Pasivin e bilancit kontabël. Rezultati është zero, pasi është institucion buxhetor.

- Llogaria 63 "Ndryshim i gjendjeve të inventarit", evidentuar në Formatin nr. 3/1, për 593lekë në fund të vitit 2017, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 3 "Gjendja e inventarit" (kolona nr. 28) në aktivin e bilancit.

*-Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël*

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë për aspektet e menaxhimit dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, kjo çështje është audituar për periudhën 2017. Në përgjithësi ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kapitulli III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", pika 30 që formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjate apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit ka rezultuar sa më poshtë vijon:

ILDKPKI ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", neni 26 ku citohet: "Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjister kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ..." dhe neni 31, citohet " ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m<sup>2</sup>, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË “INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE”

Komisioni i ngritur me urdhër të Titullarit të ILDKPKI nr. 3622, datë 10.10.2017 “Mbi inventarizimin e aktiveve” për periudhën 01.10.2016-30.09.2017 ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit

Në vitin 2017, krahasuar me inventarin e vitit 2016, rezulton se në inventarin e AQT, ka pasur ndryshime si rrjedhojë e blerjeve të ndodhura gjatë vitit.

Në përfundim të inventarizimit komisioni ka hartuar relacionin mbi përfundimin e inventarizimit, ku nuk ka rezultuar diferenca të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet.

Nga komisioni i inventarizimit në raportin e paraqitur lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, është shprehur se nuk ka diferenca të gjendjes fizike me atë kontabël. Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme, në formatin nr. 6 rakordon me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 1 të Pasqyrave Financiare.

*Ditari i magazinës është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.*

- U audituan me të zgjedhur dokumentacioni i magazinës për vitin 2017 dhe 8- mujorin e 2018. Fletë daljet dhe fletë hyrjet e aktiveve janë të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime. Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar. Kontabilizimet e fletë daljeve dhe fletë hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës.

*- Respektimi i rregullave kontabël për nxjerrjen jashtë përdorimi të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabile për shkarkimin nga magazina.*

Për vitin 2017 nuk ka pasur aktive të propozuar dhe të vlerësuara për jashtë përdorimi.

Të gjitha aktivet e inventarizuar deri me datën 31.10.2017, nga komisioni janë vlerësuar në gjendje të mirë dhe funksionale.

- **Formati nr. 4 “Burimet dhe shpenzimet për investime 2017”.** Nga auditimi rezulton se Zëri “Shpenzime për rritjen e AQ” formati 4/e e plotësuar për shumën 2,972,388 lekë, në analizë rakordon me vlerën prej 2,972,388 lekë në pasqyrën “gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme” kolona e dytë “Blerjet e krijuara me pagesë” formati 6. Totali i shtesave të krijuara me pagesë është i barabartë me burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet në formatin 6.

- **Formati nr. 9 “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”**, në përfundim të auditimit rezultoi se totali i shpenzimeve për pagat e personelit të përhershëm (të përkohshëm nuk kishte), të pasqyruar në formatin nr. 3/1, në postet përkatëse përputhej me atë të paraqitur në formatin nr. 9.

### 1/3. Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare

- **Formati nr. 5 “Pasqyrë e lëvizjes në CASH”** në përfundim të auditimit rezultoi që të dhënat për disponibilitetin në thesar përkojnë me situacionet faktike të pagesave dhe arkëtimeve të rakorduar për vitin 2017, dokumente të cilat janë bashkëlidhur edhe bilancit kontabël.

Formati ka të plotësuar edhe kontrollin sipas formulës së miratuar nga Ministria e Financave, ku llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogaria 512 “llogari në bankë” në çelje formati



## KONTROLLI I LARTË I SHTRIMIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

nr. 5 barabartë sa paraqit bilanci. Gjithashtu nga auditimi rezultoi se edhe totali i derdhjeve në buxhet (pasqyra e lëvizjes në "CASH", formati nr. 5 të ardhura jo tatimore në "CASH") ishte i barabartë me shumën e rubrikave përkatëse të derdhjeve në buxhet, të pasqyruar në akt rakordimin me Degën e Thesarit Tiranë, të pasqyruar në formatin nr. 3/2.

Në mbyllje të vitit ushtrimor, debia e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën 12,000 lekë përfaqëson vlerën e mjeteve në ruajtje në kredi të llogarisë 466 në shumën 12,000

Formati nr. 5 ka një mospërputhje jo materiale me aktivin e bilancit, pasi nga institucioni llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" është paraqitur me vlerën 0 lekë. Kjo pasaktësi në regjistrim është cituar dhe më lart tek llogaria 466 tek pasqyra e aktivitetit.

Pasqyra e lëvizjes në "CASH" viti 2017.

Në lekë

Nr.	EMERTIMI	Disponibilitet ne Thesar		Likuiditete ne Banke	
		Debi	Kredi	Debi	Kredi
a	b	c	d	e	f
1	I.TEPRICA NE CELJE TE USHTRIMIT	350,000		0	
2	II.ARKETIMET E VITIT "CASH"	184,852,964	0	0	0
3	1. Fonde nga buxheti	141,200,000		0	
4	- Fonde buxhetore korente(Plani me ndryshimet)	138,200,000			
5	- Fonde buxhetore kapitale(Plani me ndryshimet)	3,000,000			
6	2. Te ardhura e te hyra gjate vitit ne "Cash"	43,652,964	0	0	0
7	- Te ardhura tatimore ne "Cash"				
8	- Kontribute te sigurimeve shoq. e shendets. ne "Cash"				
9	- Te ardhura jo tatimore ne "Cash"	43,640,964			
10	- Te ardhura nga interesat "Cash"				
11	- Sponsorizime, grante e te ardhura te tjera "Cash"				
12	- Kredi dhe huamarrje te ndryshme	0			
13	- Te hyra nga mjetet ne ruajtje "Cash"	12,000			
14	III.PAGESAT E VITIT "CASH"	0	129,965,894	0	0
15	1, Pagesa nga buxheti per shpenzime korente		126,643,506		
16	2, Pagesa nga buxheti per shpenzime kapitale		2,972,388		
17	3, Pagesa nga te ardhurat per shpenzime korente				
18	4, Pagesa nga te ardhurat per shpenzime kapitale				
19	5, Pagesa nga mjetet ne ruajtje		350,000		
20	6, Pagesa te tjera				
21	IV. TRANSFERTA	0	55,225,070	0	0
22	1, Derdhe te ardhurave buxhet		43,640,964		
23	2, Autorizime buxhetore te pa perdorura(krente dhe kapitale)		11,584,106		
24	3, Levizje te brendshme e transferta te tjera				
25	V. SHUMA E LEVIZJEVE ( I deri IV )	185,202,964	185,190,964	0	0
26	VI. TEPRICA NE MBYLLJE TE USHTRIMIT	12,000		0	

Pasqyra e lëvizjes së fondeve (pasqyra 8), ka të pasqyruar:

Çeljen e vitit ushtrimor, llog. 101 "Fonde bazë" në shumën 130,573,359 lekë e pasqyruar edhe në pasivin e bilancit llog. 101 "Fonde bazë";

Teprica në fund e llog. 101, është e njëjtë me tepricën e saj në pasiv të bilancit kontabël, pasqyra nr. 2 është në vlerën 126,055,697 lekë.

Në lëvizjet gjatë periudhës ushtrimore në debi dhe kredi të kësaj llogarie rezultojë se :

Vlera prej 593 lekë "Paksime te fondeve baze" përputhet me Llogarinë 63 "Ndryshim i gjendjeve të inventarit", evidentuar në Formatin nr. 3/1, për 593 lekë në fund të vitit 2017,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

vlera prej 7,490,643 "Konsumi i aktiveve te qendrushme" përputhet me amortizimin vjetor te aktiveve te qendrushme nëpasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, vlera 2,972,981 lekë përputhet me vlerën e aktiveve të blera nga institucion. Vlera prej 2,972,388 "Shtesë fondi bazë" përputhet me llogarinë 218 "Inventar ekonomik" shtesë me pagesë e pasqyruar në formatin nr. 6 "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve të qëndrueshme".  
Pasqyra e e lëvizjes së fondeve 2017

Në lekë

Nr.ilog.	EMERTIMI	Teprice celje		Levizjet per periudhen		Teprica mbyllje
		Kredi	Debi	Kredi	Kredi	Kredi
b	c	1	2	3	4=1+3-2	
101	FONDE BAZE	130,573,359	7,490,050	2,972,388	126,055,697	
1,010	Fondi baze gjendje	130,573,359			130,573,359	
1,011	Shtesa fondi baze			2,972,388	2,972,388	
1012	Pakesime te fondit baze		-593		593	
1013	Pekesim nga konsumi i aktiveve qendrushme		7,490,643		-7,490,643	
1014	Pakesim nga shitja e aktiveve te qendrushme				0	
1015	Pakesim nga nxjerrja jasht perdorimit e AQ				0	
1016	Pekesim nga transfertat e AQ		0		0	
109	DIFERENCA RIVLERSIMI AQ				0	
	FONDI I BRENDESHEM	0	0		0	
105	Grante brendshme kapitale				0	
107	Vlera te caktuara ne perdorim				0	
11	Fonde te tjera veta / ndryshim gjendje				0	
12	Rezultat i mbartur				0	
13	Subvecione jashtzakoneshme				0	
145	Grante brendsh.kapitale per investime per trete				0	
15	Shuma te parashikuara rrezique e shpenzime				0	
85	Rezultati i ushtrimit (amortizim transferim kapitali)				0	
106	FONDI I JASHEM	0	0	0		
106	Grante te Huaja Kapitale					
146	Grante huaja.kapitale per investime per trete				0	
	FONDI I KONSOLIDUAR ( 1 deri 4)	130,573,359	7,490,050	2,972,388	126,055,697	

1/4. **Formati "Pyetësor dhe shënime shpjeguese"**: është plotësuar relacioni shpjegues për pasqyrat financiare dhe janë përfshirë informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku jepen informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Dhënia e shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare vjetore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme është bërë sipas formatit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të emërtuar: "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore";

### 1/5. Pasqyra e ndryshimit të aktiveve

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve te qëndrueshme (vlera bruto) 2017

Nr.	Nr.ilog.	EMERTIMI	Gjendje ne celje te ushtrimit	Shtesa gjate vitit ushtrimit						Pakesime gjate vitit ushtrimit				Gjendje mbyllje te ushtrimit
				ezje e kriju me pagese	Shtesa pa pagese	Levizje	Gjithesoj	Shitje	Nxjshet per dor.	Pakesime te tjera	Gjithesoj			
a	b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
1		U. TE TRUPËZUARA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
2	201	Prime te omisionit dhe rimbursime te huave						0					0	
3	202	Studime dhe Rretime						0					0	
4	203	Koncesione, patent te licensa e tjera ngjashme						0					0	
4/1	230	Shpenz per miratim e aktiv qendr.trupozuara						0					0	
5		U. TE TRUPËZUARA	153,382,861	2,972,388	0	0	0	2,972,388	0	0	0	0	156,355,249	
6	210	Toka, troje, Terrene						0					0	
7	211	Pyje, Kullota Plantacione						0					0	
8	212	Nderime e Konstruksione	87,120,407										87,120,407	
9	213	Rruge, mjete vegra ujme						0					0	
10	214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegje pune	13,118,406					0					13,118,406	
11	215	Mjete transport	17,774,000					0					17,774,000	
12	216	Rezerva shtetnore						0					0	
13	217	Kashe pune e graditur						0					0	
14	218	Inventar ekonomik	35,370,048	2,972,388				2,972,388					38,342,436	
17	24	Aktive te Qendr.trupozuara te demtuara						0					0	
18	28	Coftime						0					0	
19		TOTAL I (1+11)	153,382,861	2,972,388	0	0	0	2,972,388	0	0	0	0	156,355,249	

Llogaria 218 "Inventar ekonomik", paraqitet në vlerën prej 38,342,436 lekë dhe sipas inventarit ka ndryshime pasi janë bërë hyrje me pagesë në vlerën prej 2,972,388 lekë. Blerje



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

pajisje kompjuterike në shumën 2,798,388 lekë dhe 174,000 lekë pajisje zyre (ngrohëse, poltron dhe tavolinë). Komisioni i inventarizimit në relacion është shprehur për inventarin gjendje në magazinë (te reja dhe mall i përdorur dhe i kthyer) si dhe për inventarin në përdorim të personelit, ku janë mbajtur kartelat me personat përgjegjës që kanë në përdorim dhe ngarkim këto aktivet.

Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve nuk është propozuar për daljen jashtë përdorimi të aktiveve, çka do të thotë se i gjithë inventari gjendje (AQT) në institucion është në gjendje të mirë funksionale.

Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara" (Llog. nr. 219) prej 37,475,873 lekë është pasqyruar në bilanc dhe kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr.7. Formati 7 "Pasqyra e amortizimeve", nga auditimi rezulton se është plotësuar sipas Udhëzimit të MF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisve që varen prej tyre, si dhe njësisve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj"

Amortizimi vjetor është llogaritur dhe kontabilizuar sipas normave të përcaktuara në VKM nr. 401 të vitit 1989, ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike të përdoret ligji aktual fiskal "Për Tatimin mbi të Ardhurat" me norma amortizimi 25% dhe aplikimi të behet mbi vlerën e mbetur.

Normat e amortizimit janë përlllogaritur sipas VKM nr. 401, datë 23.10.1989 "Për llogaritjen e normave të reja të amortizimit të makinerive, të pajisjeve dhe të mjeteve të transportit", ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike është përdorur ligji aktual fiskal "Për tatimin mbi të ardhurat" ku norma e amortizimit është 25% dhe aplikimi bëhet mbi vlerën e mbetur.

Normat janë:

- 15% për studime dhe kërkime;
- 1% për ndërtesat dhe konstruksionet;
- 3% për inventarin ekonomik;
- 25% për pajisjet informatike, kompjuterike e elektronike;
- 6% për makineritë e pajisjet operacionale, instrumente e vegla; dhe
- 14% për mjetet e transportit.

Në lekë

Nr. llog	Emri i llogarisë	Shuma e Aktiveve sipas bilancit	Pajisje të reja të ardhura në 2017	Vlera e amortizimit në vite	% e Amortizimit	amortizim mbi vlerën e mbetur	Totali i amortizimit për vitin 2017
212	Ndërtime e Konstruksione	87,120,407		9,678,976	0.01	871,204	10,550,180
214	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune	13,118,406		2,426,834	0.058	473,002	2,899,836
215	Mjete transporti	17,774,000		2,057,590	0.138	2,168,865	4,226,455
217	Kafshe pune e prodhimi				0.1		0
218	Inventar ek, pajisje kompjuterike	24,667,051	2,798,388	13,046,167	0.25	3,570,808	16,616,975
218	Inventar ekonomik	13,675,385	174,000	2,775,663	0.03	406,764	3,182,427
219	Amortizimi aktiv.Qendr.te trupëzuara(-)						0
	Totali	156,355,249	2,972,388	29,985,230	1	7,490,643	37,475,873

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të regjistruar në kontabilitet u konstatua se disa aktive kanë një vlerë shumë të vogël, pasi u është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite. Aktivët vazhdojnë të jenë në përdorim dhe gjendje pune, por nëse institucioni nuk merr masa në vazhdimësi për të ngritur grup pune me ekspertë të fushës, për artikujt, për të shqyrtuar jetën e dobishme dhe vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, pas disa periudhash ushtrimore do të rezultojnë me vlerë negative ose me vlerë zero. Ndryshimet në jetën e pritshme të dobishme dhe të vlerës së tyre të kontabilizohen duke ndryshuar periudhën e amortizimit apo metodën, sipas rastit, dhe të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël.

#### Auditimi i transaksioneve:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

Për periudhën e kohës objekt auditimi, njësia shpenzuese ka kryer rregullisht regjistrimin dhe dokumentimin e veprimeve kontabile në ditarin e bankës, dhe ka transferuar shumat e ditarëve në pasqyrat e bilancit të vitit 2017. Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konformë rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Dokumentacioni është kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe sistematike në ditarin e bankës. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

Nga grupi i auditimit për periudhën buxhetore të vitit 2017 dhe 8- muajorin e 2018u bë një përzgjedhje të disa transaksioneve me palët e treta.

Realizimi i shpenzimeve për periudhën objekt auditimi ishin:

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për muajin vitin 2017 në vlerën totale 129,875,902 lekë.

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për muajin 8- muajorin e 2018 në vlerën totale 86,621,536 lekë.

Nga këto grupi i auditimit, me përzgjedhje auditoi transaksionet në Aneksi VI

Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*" për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

*Nga auditimi rezultoi:*

- Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.

- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

Në Urdhër-shpenzimet është bashkëlidhur dokumentet autorizues, dokumente vërtetues, dokumente të kontabilitetit, etj në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*". Marrja në dorëzim e shërbimeve sipas kontratave të lidhura për mallra/shërbime janë të konfirmuara dhe dokumentuara rregullisht nga një komision i ngritur nga ILDKPKI, në përputhje me përcaktimet e dispozitave dhe kuadrit nënligjor mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm dhe kontabilitetin publik.

## B. VLERËSIMI I FUNKSIONIMIT TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT, SI DHE VLERËSIMI I AUDITIMIT TË BRËNDSHËM.

2.1-Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informim komunikimi, monitorimi. Përbushja e qëllimeve, objektivave të njësisë publike dhe caktimi i nëpunësit autorizues.

2.2-Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor të auditimit nga ana sasiore dhe analiza sipas llojeve dhe zbulimeve si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit. Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara.

### 2.1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në zbatim të nenit 9 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, është kryer vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të ILDKPKI-së. Në kuptimin e këtij ligji, menaxhimi dhe kontrolli financiar përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË “INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE”

Në bazë të ligjit organik, ILDKPKI është një shërbim publik autonom me statusin e një administrate shtetërore qendrore, që përgjigjet para Kuvendit të Shqipërisë.

ILDKPKI është institucion publik, buxhetor. Planifikimi buxhetor për funksionimin normal të tij hartohet nga institucioni dhe miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili vë në dispozicion fondin e akorduar.

Monitorimi i veprimtarisë së këtij institucioni dëshmon një situatë positive, e cila evidentohet si më poshtë vijon;

#### Për periudhën objekt auditimi 2017 deri në 30.08.2018 rezultoi se:

Nga auditimi, sipas kërkesave të pikës të nenit 18/1, nenit 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, “Nëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual”.

Nga ana e strukturave drejtuese të ILDKPKI -së janë hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë *pyetësorët e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit*, për vitin 2017 me shkresë nr. 4199 prot datë 29.12.2017, ndërsa për vitin 2018 me shkresë nr. 778 prot datë 19.02.2018.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresë nr. 16409 prot datë 15.11.2017 të Drejtorisë e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në lidhje mbi monitorimin e cilësisë së sistemit të Kontrollit të Brendshëm, i cili është bazuar dhe në monitorimin e kryer direkt nga Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (DH/MFK), si dhe në bazë të gjetjeve të auditimit të brendshëm të institucionit të mësipërm (DH/MFK), në përfundim të procesit është shprehur se, ILDKPKI, rankohet sipas nivelit të referimit me 152 pikë, midis institucioneve të pavarura.

Konstatohet se ILDKPKI- ja, funksionon sipas rregullores së brendshme nga Inspektori i Përgjithshëm me nr. 1499 datë 12.09.2014, e cila është përditësuar dhe ndryshuar, në bazë të Vendimit nr. 48/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 55/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 4, germa “b”, që përcakton se “Nëpunësi autorizues i të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë përgjegjësi kryesore hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore, në përputhje me objektivat e miratuara nga titullari i njësisë”, nga institucioni janë hartuar, miratuar, publikuar dy deklaratat për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të ILDKPKI, të cilat janë dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, respektivisht me shkresat nr. 788 prot datë 20.02.2018 për vitin 2017, ndërsa për vitin 2018 është në poqes.

Nisur sa më sipër, nga auditimi rezultoi se, gjatë vitit 2017, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në përmbushje të misionit dhe funksionimit të tij, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, të ndryshuar, ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, të ndryshuar, në lidhje mbi parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sektorin publik e privat nëpërmjet hetimit administrativ të sinjalizimit të brendshëm e të jashtëm, të mbrojtjes së individëve që





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

sinjalizojnë për veprime dhe praktika të dyshuara të korrupsionit sipas ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, si dhe detyrime të tjera sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, realizimi i të cilave mbështetet tërësisht në Programin Buxhetor Afatmesëm.

Kështu, në programin buxhetor të ILDKPKI janë hartuar deklarata e misionit si dhe objektivat themelore për sigurimin e një menaxhimi eficient dhe efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare.

Mbështetur në ligjet e sipërcituara mbi të cilën ushtron veprimtarinë e tij, ILDKPKI, për mbarëvajtjen institucionale, mbështetjen e stafit punonjës në funksion të një vendimmarrje të paanshme, transparente në kontrollin e deklarimit të pasurive, legjitimitit të burimeve të krijimit, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët dhe personat e lidhur me ta, parandalimit të konfliktit të interesave publike dhe atyre private të zyrtarit në ushtrimin e funksioneve të publike si dhe arritjen e standardeve bashkohore, me qëllim hartimin e politikave dhe procedurave për administrimin efektiv të fondeve buxhetore, është përcaktuar qartë misioni dhe objektivat për vitin 2017;

Nga auditimi i deklaratës dhe raporti vjetor për Cilësinë e Sistemeve të kontrollit të Brendshëm, u evidentua se, sipas misionit të Inspektoratit të Lartë ka të bëjë me menaxhimin efektiv i fondeve buxhetore të akorduara për ILDKPKI, duke mundësuar zbatimin efektiv të tyre, në funksion të;

- Deklarimit dhe kontrollit të interesave private nëpërmjet hetimit dhe kërkimeve administrative për vërtetësinë, saktësinë dhe legjitimitetin e burimit të krijimit të pasurive për të zgjedhurit, nëpunësit publik, për familjarët dhe personat e lidhur me ta.

- Garantimit të një vendimmarrje të paanshme, transparente, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesave publike dhe atyre private të zyrtarit, në ushtrimin e funksioneve të veta, si dhe arritjen e standardeve ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit.

- Hetimit të rasteve të veprimeve korruptive të paraqitura nga sinjalizuesit, si dhe garantimin e mbrojtjes së tyre nga çdo veprim hakmarrje të ndërmarrë si rrjedhojë e raportimit.

- Bashkëpunimit me organet e auditimit dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për arritjen e standardeve ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit dhe krimin ekonomik dhe sanksionimin e masave disiplinore, kundërvajtjeve administrative dhe kallëzimeve penale për zyrtarët dhe personat e lidhur me ta.

- Parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sektorin publik e privat.

Për të garantuar një menaxhim financiar dhe kontrolli në përputhje me legjisllacionin përkatës, kërkesat e buxhetit, si dhe parimet e menaxhimit financiar, me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi, në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive Konfliktit të Interesave, janë krijuar sisteme kontrolli të brendshme, duke synuar drejt përmbushjes optimale dhe realizimit të objektivave të vitit 2017, si më poshtë;

- Drejtimi dhe përmirësimi i politikave dhe mekanizmave për kontrollin e vërtetësisë dhe saktësisë së pasurive, të parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave të zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike, si instrumente të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit.

- Forcimi i mëtejshëm i teknikave të hetimit administrativ jo vetëm në identifikimin e pasurive të fshehura apo të padeklaruara, por sidomos në kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të rasteve të konfliktit të interesave.

- Hetimi mbi pasuritë dhe burimin e të ardhurave të personave jo zyrtarë që kanë interesa të përbashkëta me subjektin deklarues dhe forcimi i punës për zbulimin e rasteve të fshehjes apo deklarimit të rremë të zyrtarëve që abuzojnë me pushtetin.

- Parandalimi i rasteve të pasurimit në rrugë abuzive të zyrtarëve dhe të personave të lidhur me ta.

- Parandalimi i rasteve të konfliktit rast pas rasti apo të vazhdueshëm të interesave të zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike.

- Penalizmi i rasteve të abuzimit nga zyrtarët me funksionet e tyre publike.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

- Parandalimin dhe goditja e korrupsionit në sektorin publik e privat nëpërmjet hetimit administrativ të sinjalizimit të brendshëm e të jashtëm dhe mbrojtjen e individëve që sinjalizojnë për veprime dhe praktika të dyshuara të korrupsionit nga hakmarrja në përputhje me ligjin nr. 60/2016, datë 2.6.2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

Nga auditimi i këtij materiali dhe nga takimet me nëpunësin autorizues, institucioni për gjatë vitit 2017, është përpjekur për konsolidimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Deklarata e Misionit të ILDKPKI, është hartuar çdo vit, si dhe në vitin 2017 është miratuar në dokumentin e PBA 2018-2020 faza e parë.

Kanë përfunduar dhe janë miratuar dokumentet strategjike të ILDKPKI, dhe si pjesë përbërëse për arritjen e këtyre strategjive, janë hartuar dhe plan-veprimet përkatëse.

#### Vlerësimi i sistemit të MFK-së

Nga auditimi, u konstatua se, në mbështetje të legjislacionit në fuqi, mbi menaxhimin financiar e kontrollin, ILDKPKI-ja realizon kontrole të brendshme, sipas procedurave administrative, duke miratuar dhe urdhëruar, për të bërë të mundur, duke lenë gjurmë të auditimit mbi menaxhimin e fondeve publike me efektivitetet, transparencë, ekonomi dhe eficensë.

Ky sistem është mbështetur sipas proceseve, të cilat ofrojnë garanci të arsyeshme për arritjen e objektivave nëpërmjet;

- Efektivitetit dhe eficensës së veprimeve të kryera,
- Përputhshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme,
- Rregullueshmërisë dhe bbesueshmërisë në raportimet financiare,
- Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në detyrimet e përcaktuara në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe në udhëzimet e dhëna nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit është e nevojshme përmirësimi për të pasur në mënyrë sistematike monitorimin e kontrollit të brendshëm.

Kështu, nga auditimi u evidentua se monitorimi i veprimtarisë së këtij institucioni është realizuar sipas rubrikave të përcaktuara nga ligji nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, si më poshtë vijon:

- ILDKPKI disponon Planin Operacional të Punës ashtu dhe Planin e Zhvillimit të MFK.
- Delegimi i detyrave është një praktikë që ka gjetur zbatim në këtë institucion. Kështu ka patur delegime të detyrave në formate të caktuara, por në asnjë rast nuk është deleguar detyra e Koordinatorit të Riskut apo as ajo e Nëpunësit Zbatues. Sipas Manualit të MFK, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit mbetet koordinator i riskut dhe MFK.

- Institucioni ILDKPKI, në lidhje me menaxhimin e burimeve njëzëzore, disponon në mënyrë ligjore përshkrimet e punës për punonjësit dhe kryhen vlerësime periodike. Gjithashtu institucioni kryen trajnime të vazhdueshme, me përfshirje të gjere të numrit të të punësuarve pranë tij.

- Në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kanë regjistruar rrisht të miratuar, listë procesesh të punës si dhe gjurmë auditit.

- Gjithashtu ky institucion ka miratuar dhe zbaton në vazhdimësi, urdhërin për menaxhimin e vlerave materiale, në bazë të udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave.

- Grupi Menaxhimit Strategjik përbëhet nga Inspektori i Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë së Financave dhe Administrimit, Inspektorë si dhe Përgjegjësi i Sektorit IT. GMS mblidhet në mënyrë periodike për të diskutuar dhe marrë vendime për çështje të ndryshme.

- Në ILDKPKI, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", janë përcaktuar Nëpunësi Autorizues si dhe Nëpunësi Zbatues dhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË “INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE”

është njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës për ndryshimet përkatëse.

#### Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrave, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; politikat dhe praktikrat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve, etj.

#### a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Në përputhje me rregullat dhe parimet e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” nga ana e institucionit ILDKPKI është hartuar dhe miratuar “Rregullorja në zbatim të Kodit të Etikës” nga Inspektori i përgjithshëm, në bazë të Urdhrit nr. 1284 datë 02.09.2014, bazuar në bazën ligjore funksionale të institucionit kushtetues si dhe në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”.

#### b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse të njësisë, sipas “Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të Veprimtarisë së ILDKPKI-së”, miratuar sipas Urdhër nr. 1499, datë 12.9.2014, i ndryshuar, ku në bazë të saj janë përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorëve, Ndihmës Inspektorëve, çdo drejtorie e sektori si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit.

Detyrat funksionale të çdo punonjësi janë përcaktuar në përshkrimet e punës për çdo funksion, dhe janë nënshkruar nga secili prej tyre. Monitorimi i zbatimit të këtyre vlerave kryhet nëpërmjet vlerësimeve periodike.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, struktura organizative ka pësuar ndryshim, sipas Vendim të Kuvendit të Shqipërisë, nr. 48/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 55/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”, ku është konstatuar se ILDKPKI-ja, funksionon sipas rregullores së brendshme nga Inspektori i Përgjithshëm me nr. 1499 datë 12.09.2014, e cila është përditësuar dhe ndryshuar, në bazë të Vendimit nr. 48/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 55/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”.

Në bazë të rregullores të përditësuar, u konstatua, se nëpërmjet përshkrimit të punës për çdo pozicion pune, është kryer ndarja e detyrave dhe e përgjegjësisë, e vartësisë funksionale dhe administrative si dhe linja e raportimit. Nga drejtuesi i institucionit, sigurohet mbikëqyrja e monitorimi të punës për secilin punonjës, nëpërmjet raporteve periodike nga drejtuesit e drejtorive dhe sektorët, në mënyrë që të sigurohet si duhet realizimi i objektivave për çdo pozicion punësimi si dhe garantimi i integritetit personal dhe etika profesionale. Në funksion të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, në neni 12, nëpunësi zbatues (NZ), është



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

niveli menaxherial në vartësi direkt të Inspektorit të Përgjithshëm. Në funksionet e tij, drejtori i Financës përgjigjet dhe mbulon funksionin e planifikimit, monitorimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetin si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të institucionit, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi.

### c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe menaxherët e tjerë të institucionit, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 15 "Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave", si dhe Kapitulli III "Delegimi i detyrave", të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, institucioni ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, si dhe raste të delegimit të autoritetit tek niveli më poshtë, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë që të gjithë punonjësit të mbikëqyren në kryerjen e detyrave të tyre nga drejtuesit dhe struktura aktuale për mangësitë e hallkave të monitorimit të programeve të nxitjes së punësimit nuk është plotësisht e përshtatshme për realizimin e objektivave të caktuara.

### d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të institucionit janë caktuar normat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave / drejtorive dhe zyrave të varësisë, etj. Konstatohet se, nga ana e drejtuesve sipas niveleve (eporët e drejtpërdrejtë), janë kryer vlerësimet vjetore dhe periodike të performancës në punë për çdo punonjës, sipas përcaktimeve në dispozitat e shërbimit civil dhe akteve të dala në zbatim të tij.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve të objekt auditimit, në ILDKPKI janë organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve për tu njohur dhe shkëmbyer përvojë mbi praktikat më të mira në fushën e menaxhimit financiar dhe kontroleve të brendshme për sektorin publik.

Kështu, u evidentua se, ILDKPKI-ja, ka vlerësuar si pjesë të objektivave dhe politikave të saj ngritjen dhe ruajtjen e kapaciteteve teknike profesionale të stafit të saj, duke realizuar trajnimeve, gjatë vitit 2017, ILDKPKI në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e saj ndërkombëtarë dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASP), ka përfunduar kurrikulën e Trajnimit të Trajnerëve, në bazë të të cilës janë organizuar dy trajnime për të gjithë trajnerët e ASPA-së, në total 38 trajnerë, të përfshirë në kurrikulat kundër korrupsionit gjatë muajit korrik 2017. Gjithashtu në korrik 2017, janë organizuar dy sesione trajnimesh, për rreth 50 njësi përgjegjëse, në sektorin publik në nivel qendror dhe vendor.

Gjatë muajit maj 2017, janë organizuar dhe janë mbajtur dy sesione trajnimesh për stafin e ILDKPKI-së, me 28 inspektorë.

Në qershor të vitit 2017, është kryer vizita studimore në Holandë, pranë institucioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve ku morën pjesë 10 përfaqësues nga ILDKPKI (10 inspektorë).

Për vitin deri në 31.08.2018, pranë ILDKPKI-së janë zhvilluar trajnime në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, janë organizuar 5 trajnime, të cilat kanë trajtuar tematika mbi transparencën dhe prokurimet publike, të organizuara nga ASPA, Këshilli i Evropës si projekte të binjakëzimit.

Dosjet e personelit për punonjësit e ILDKPKI përmbajnë në çdo rast dokumentacion të plotë, zbatim kërkesat e VKM nr. 117, datë 05.03.2014.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

### Menaxhimi i riskut.

Pas planifikimit të fondeve buxhetore, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 11 "Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë", pika 2, si dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli III, pika 2.5.2 "Menaxhimi i Riskut", ky institucion për periudhën objekt auditimi (viti 2017) dhe në vitin në vazhdim 2018, nuk është deleguar detyra e Koordinatorit të Riskut apo as ajo e Nëpunësit Zbatues. Sipas Manualit të MFK, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit mbetet koordinator i riskut dhe MFK. Për menaxhimin, identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e risqeve për vitin 2017, është hartuar Regjistri i Riskut dhe është miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm me nr. 3993 prot, datë 17.11.2017.

Regjistri i riskut është përgatitur duke marrë për referencë, ligjin për menaxhimin financiar dhe manualit të tij si dhe duke u mbështetur në objektivat e identifikuar në PBA 2018-2020, si dhe objektivat e punës të çdo sektori/drejtorie për vitin 2017.

### Aktivitetet e kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme dhe në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave. Nëpunësi autorizues në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor. Referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar neni 16, si dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III "Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit", pika 3.2 "Cikli i MFK-se", Hapi 5 "Gjurmët e auditimit", "Mbi gjurmën e auditimit", nga ana e ILDKPKI –së janë hartuar gjurmët e auditimit për prokurimet me vlerë deri në 800.000 lekë., (miratuar nga ana Inspektori i Përgjithshëm me nr. 3397 prot, datë 28.07.2016 me Urdhër nr. 1580, datë 28.07.2016).

Gjithashtu, institucioni ILDKPKI-së, në zbatim të ligjit "*Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin*", ka nxjerrë një sërë aktesh në zbatim rigoroz të tij, për menaxhimin e aktiveve.

Gjatë aktiviteteve të ndryshme të punës, janë kryer kontrole të caktuara që kanë të bëjnë me ndarjen e detyrave në mënyrë që i njëjti person mos të përfshihet në të njëjtën kohë në disa procese, si (miratimin, zbatimin, autorizimin, saktësimin e veprimeve para kryerjes së pagesave, etj). Janë ushtruar aktivitete të kontrollit të brendshëm në likuiditetet me arkë me degën e thesarit, në administrim, qarkullimin dhe ruajtjen e aktiveve. Për saktësimin e të dhënave të përfshira në një dokument, është ushtruar sistemi me të paktën dy firma. Urdhër shpenzimet apo kryerja e pagesave autorizohet gjithmonë pas firmës së nëpunësit zbatues dhe nëpunësi autorizues.

Drejtuesi i Programit "*Planifikim Menaxhimi, Administrim*", është iniciues i hartimit të PBA-se faza e parë dhe e dytë.

Gjithashtu kryhen edhe aktivitete të kontrollit të cilat kanë të bëjnë me monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre.

Për të plotësuar nevojën për informacion, njësia ka instaluar sistemin e IT-së, ku kompjuterët janë të lidhur me serverin qendror. Kontrolli i sistemit realizohet kryesisht për të siguruar mirëfunksionimin e këtyre elementeve kryesor dhe të gjithë elementeve të tjerë që lidhen me to.

### Informimi dhe komunikimi.

Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara. Komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është kryer në formën dhe kohën e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

duhur për ti ndihmuar përmbushjes së detyrave dhe të përgjegjësive. Drejtuesit e ILDKPKI zotërojnë informacion te mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme por, njësia nuk ka hartuar një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre.

Nga auditimi, rezultoi se, shkëmbimi i informacionit ndërmjet punonjësve të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht, kryhet sipas rregullave të brendshme të strukturuar për marrjen dhe dhënien e informacionit ndërmjet niveleve të ndryshme duke respektuar nivelin e hierarkisë, në mënyrë shkresore dhe elektronike në funksion të arritjes së objektivave dhe menaxhimit të mirë të fondeve publike. Kujdes të veçantë i kushtohet komunikimit të informacionit në formën dhe kohën e duhur në mënyrë që të përmbushen sa më mirë përgjegjësitë e punonjësve dhe manaxherëve.

Informacioni dhe komunikimi, është i lidhur dhe me teknologjinë e informacionit, zbatimin e rregullave të tyre për gjenerimin, përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e informacionit në ILDKPKI. Inspektorati i Lartë disponon një sistem kritik për realizimin e objektivave institucionale dhe ruajtjen e të dhënave nëpërmjet të cilit administrohen dhe kontrollohen deklaratat e interesave private të zyrtarëve (*regjistrim, skanim, kontroll aritmetik e logjik etj*). Për këtë sistem, ekziston procedura e mirë përcaktuar, për funksionimin korrekt të rrjetit TIK të institucionit, që aplikohet në mbarim të çdo dite pune.

Procese pune mjaft të rëndësishme për arritjen e objektivave të institucionit si regjistrimi, skanimi dhe kontrolli aritmetik e logjik i deklaratave të interesave private realizohen nëpërmjet sistemit informatikë "Hidaa Cms". Ky sistem është i pajisur me raporte dhe statistika që ndihmojnë në monitorimin e ecurisë së punës të punonjësit, sektorëve apo institucionit në tërësi.

Në ILDKPKI, funksionon Sektori i Teknologjisë së Informacionit si dhe përdorimi i email-ve si një rrugë e mundshme për të kërkuar apo shkëmbyer informacion me të gjitha institucionet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

#### **Monitorimi.**

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Titullarët e njësisë publike (NA), janë përgjegjës për ngritjen dhe zbatimin e e një sistemi për monitorimin e MFK-së, me qëllim vlerësimin e funksionimit të tij në mënyrën e duhur, si dhe rifreskimin e tij në kohën e duhur kur ndryshojnë rrethanat. Monitorimi i kontrollit të brendshëm duhet të garantojë se të gjitha problemet e identifikuara, trajtohen që në momentin në të cilin zbulohen.

Monitorimi kryhet nëpërmjet monitorimit dhe performancës financiare të shpenzimeve të buxhetit, analizave të zbatimit të buxhetit nga Drejtuesi i Programit, Drejtoria e Financës dhe Administrimit, çdo muaj, tremujor dhe vjetor apo sa herë të lind nevoja.

Për monitorimin e proceseve dhe aktivitetëve përdoren një sërë procedurash nga Titullari, nëpunësi Autorizues dhe Zbatues. Në përgjithësi raportohet mbi realizimin e buxhetit, apo monitorimin e strategjive dhe objektivave.

Në ILDKPKI, nuk ka strukturë të auditimit të brendshëm.

#### **Masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimi për të ardhmen**

Nga auditimi, u konstatua se, gjatë vitit raportues 2017 deri në 31.08.2018, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e mjedisit të kontrollit nëpërmjet kontrolleve të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

drejtpërdrejta për realizimin e rekomandimeve të dhëna nëpërmjet raportimeve mujore dhe tremujore nga menaxheri i çdo strukture.

Për vitin 2017, në zbatim të Urdhërit nr.1580, datë 28.7.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm "Për gjurmët standarte të auditit në ILDKPKP" janë ushtruar kontrole të drejtpërdrejta në zbatim të gjurmëve standarde të auditit ndërmjet të cilave për;

- Prokurimin e fondeve publike me vlerë mbi 800 mijë lekë.
- Prokurimin për blerje të vogla.
- Për zbatimin e buxhetit,
- Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm,
- Për menaxhimin e aktiveve.

Kështu nisur sa më sipër, u identifikua që është e nevojshme për të implementuar kuptimin dhe zbatueshmërisë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit të MFK-së, duke e realizuar më tepër kualifikime e seminare për zberthimin e ligjit, mënyrën e analizës së menaxhimit të riskut duke siguruar një pjesëmarrje në këto trajnime të drejtuesve të programeve buxhetore, nëpunës autorizues dhe zbatues, si dhe specialistë të tjerë me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të punës së institucionit të audituar.

### 2.2 Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimet e mëparshme

Në bazë të auditimit të mëparshëm të Programi të Auditimit nr. 269/1, datë 30.04.2016, me objekt "Auditimi i aktivitetit ekonomiko-financiare" për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2015, ku në përfundim është finalizuar Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe me Vendimin nr. 72, datë 29.06.2016 dhe të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 269/6, datë 04.07.2016.

Gjithashtu, është ushtruar auditim në zbatim të Programit të auditimit nr. 1115, datë 04.11.2016 "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të ushtruar në 9-mujorin e viti 2016", ku në përfundim të auditimit është miratuar vendimi nr. 193, datë 31.12.2016 të kryetarit të KLSH-së.

Grupi i audituesve, në zbatimit të të Programit të Auditimit nr.1083/1, datë 17.09.2018 me objekt auditimi, "Auditim i pasqyrave financiare", nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se;

- Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve nga marrja dijeni me shkresën nr. 3234/1, datë 22.07.2016, së bashku me programin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit, sipas afateve të përcaktuar.

- Në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka kthyer përgjigje brenda afatit 6 mujor me shkresën nr. 3234/2 prot, datë 24.11.2016.

-Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 1115, datë 04.11.2016 konstatohet se:

*-Janë rekomanduar gjithsej 5 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 5 rekomandime.*

*Më hollësisht, mbi realizimin e rekomandimeve konstatohet si më poshtë:*

1. Realizimi i shpenzimeve të programuara për vitin 2015, është në masën 96.6% ose 3,633 mijë lekë më pak se plani me ndryshime. Realizimi në këtë masë në institucion ka ardhur kryesisht nga mos realizimi i shpenzimeve operative. Shpenzimet e pagave për këtë vit janë në

10801  
98





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË “INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE”

masën 65,589 mijë lekë dhe përbëjnë rreth 63% të totalit të shpenzimeve nga 60% që zinin për vitin 2014. Ky zë është realizuar në masën 98.9%. Shpenzimet operative janë realizuar në masën 85%. Peshën kryesore në këtë zë e kanë “Shpenzime nga të tretët” që zënë 50% të këtij zëri, me rreth 6,529 mijë lekë për vitin 2015, me një rritje krahasuar me nivelin prej 4,846 mijë lekë të vitit 2014. “Materiale zyre dhe të përgjithshme” zënë rreth 20% të shpenzimeve operative ose në vlerë kapin shumën e 2,667 mijë lekë, zë që është ulur ndjeshëm referuar nivelit të tyre për vitin 2014. Për periudhën objekt auditimi, ILDKPKI ka realizuar të ardhura nga gjambat, në shumën 25,911 mijë lekë për vitin 2015 me një rritje 242% kundrejt vitit 2014, ku niveli i të ardhurave ishte vetëm 7,581 mijë lekë për viti 2014 dhe krahasuar me vitin 2013 rritja është e konsiderueshme pasi për këtë vit institucioni ka deklaruar vlerën 375 mijë lekë të ardhura. Konstatohet se, të ardhurat janë realizuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, nga gjambat administrative, të shlyera nga vetë subjektet apo të mbledhura nga zyrat përmbarrimore. Të ardhurat e realizuara janë derdhur 100% në buxhetin e shtetit.

### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Të vijohet me praktikën e monitorimit të vazhdueshëm të shpenzimeve korente të cilat duhet në të gjitha rastet ti përgjigjen nivelit të aktivitetit dhe të rriten në përpjesëtim të drejtë me nivelin e të ardhurave të realizuara nga institucioni. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të shikohet mundësia e përdorimit të një pjesë të të ardhurave të realizuara për investime kapitale aq të rëndësishme në kontekstin e forcimit të kapaciteteve institucionale.

### **Përgjigja e institucionit:**

ILDKPKI, vijon me praktikën e monitorimit të shpenzimeve korrente për vitin 2016, duke u mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa nëpunësve Publikë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar dhe së fundmi për ushtrimin e kompetencave që ka ILDKPKI në referencë të ligjit, nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Monitorimi i realizimit të shpenzimeve ndiqet me prioritet për eliminimin e risqeve të mundshme, kjo nëpërmjet ndjekjes së planifikimit buxhetor mujor dhe realizimeve përkatëse me Degën e Thesarit Tiranë, ku çdo muaj miratohet evidenca e realizimit të shpenzimeve konkretizuar me evidencën e realizimit të shpenzimeve Janar – Tetor 2016 dhe raportin e monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit të ILDKPKI, për 9 mujorin e vitit 2016, në Ministrinë e Financave.

Në lidhje me të ardhurat e realizuara (gjomba) në zbatim të ligjeve organike mbi të cilat funksionon Inspektorati i Lartë, theksojmë se kalojnë në Buxhetin e Shtetit në masën 100%, kjo në mbështetje të nenit 41, “Ekzekutimi i gjobave” të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa nëpunësve Publikë”, i ndryshuar si dhe të nenit 41, “Shpërndarja e të ardhurave të mbledhura nga gjambat”, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundravajtjet administrative”.

Çdo muaj rakordohet me Degën e Thesarit Tiranë për të ardhurat e realizuara dhe të derdhura 100% në buxhet të shtetit, ku për periudhën Janar- Tetor 2016, është realizuar vlera prej 21,250,320 lekë.

### **Komenti i grupit të auditimit**

Dokumentacioni i paraqitur në përgjigjen e subjektit është bashkëlidhur përgjigjes në lidhje me këtë rekomandim.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i zbatuar plotësisht.*

2. Për periudhën objekt auditimi është kryer inventarizimi fizik i aktive të qëndrueshme, vlerave materiale, inventari i imët, sipas Urdhrave të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 1032, datë 28.02.2014, nr. 8, datë 23.01.2015, nr. 38, datë 09.03.2015 dhe nr. 1795, datë 16.11.2015 “Mbi inventarizimin e aktiveve të ILDKPKI-së”. Konstatuam se për materialet jashtë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË “INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE”

përdorimit, për pajisjet që janë të dëmtuara të ndodhura stok në magazinë me Urdhrat e Brendshëm nr. 96, datë 30.04.2014, nr. 39, datë 09.03.2015 dhe nr. 1833, datë 18.11.2015 “Për miratimin e komisionit të vlerësimit të vlerave materiale, të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit apo tjetërsim”, është ngritur komisioni i vlerësimit për materialet jashtë përdorimit apo tjetërsimit, sipas dispozitave në fuqi. Të gjitha fletët e inventarit janë plotësuar në sasi dhe në vlerë dhe janë të firmosura nga të gjithë anëtarët e komisionit. Është propozuar për tjetërsim kapital një automjet Volkswagen Passat AA 302 BI. Gjithashtu mbështetur në rezultatet e inventarizimit të pjesshëm të vitit 2015, në relacionin nr. 272/1, datë 02.02.2015, komisioni i inventarizimit ka propozuar një pjesë të pajisjeve kompjuterike, një automjet dhe inventar ekonomik të panevojshme, që qëndrojnë në magazinë, të transferohen pa pagesë në Bashkinë Librazhd, pasi është marrë parasysh koha e vënies në shfrytëzim. Me urdhrin nr. 582 datë 13.02.2015 për krijimin e komisionit të tjetërsimit të aktiveve për transferim kapital është ngritur komisioni i përbërë nga 5 punonjës, i cili vendosi të bëjë kalimin pa pagesë të 41 aktiveve, me vlerë totale fillestare 5,236,765 lekë dhe vlerë të mbetur totale 1,029,257 lekë. Me urdhrin e brendshëm nr. 599 datë 17.02.2015 “Për zbatimin e procedurave të transferimit kapital pa pagesë të aktiveve për tjetërsim” të firmosur nga titullari i institucionit janë ndjekur procedurat e mëtejshme për transferimin kapital të tyre në Bashkinë Librazhd. Nga auditimi i procedurave të inventarizimit të aktiveve, gjatë vitit 2014 dhe 2015, në mënyrë të njëpasnjëshme u konstatua pjesëmarrja e të njëjtit punonjës në komisionin e inventarizimit të pjesshëm, apo të plotë të aktiveve të institucionit, veprim që është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke sjellë ekspozimin e këtij procesi ndaj një risku potencial në lidhje me keqadministrimin, apo dhe abuzimin me të dhënat e konfirmuara.

#### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Nga ana e ILDKPKI të merren masat, që në komisionet e njëpasnjëshme të inventarizimit, të plotë apo të pjesshëm për të njëjtin grup aktivesh, të mos marrë pjesë i njëjti person, në funksion të mirë menaxhimit të aktiveve dhe minimizimit të riskut në ruajtjen me efektivitet të tyre nga veprimet abuzive gjatë trajtimit të elementeve pasurorë të njësisë.

#### **Përgjigja e institucionit:**

Në lidhje me miratimin e anëtarëve të komisionit të inventarizimit dhe tjetërsimin e vlerave materiale, ky rekomandim është zbatuar menjëherë bazuar në dispozitat ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, konkretizuar me Urdhrat e Inspektorit të Përgjithshëm;

- Nr. 1907, datë 17.10.2016, “Mbi inventarizimin e aktiveve të ILDKPKI”

- Nr. 1912, datë 2.11.2016, “Për miratimin e komisionit të vlerësimit të aktiveve të propozuara për tjetërsim”.

- Nr. 2187, datë 15.11.2016 “Për krijimin e komisionit për tjetërsimin e aktiveve për kalim kapital pa pagesë”

#### **Komenti i grupit të auditimit**

Dokumentacioni i paraqitur në përgjigjen e subjektit është bashkëlidhur përgjigjes në lidhje me këtë rekomandim.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i zbatuar plotësisht.*

3. Nga auditimi i procedurës “Kërkesë për Propozim” me objekt “Blerje Tонера”, të zhvilluar gjatë vitit 2014, me vlerë 1,666,667 lekë pa TVSH, u konstatua se megjithëse nga Njësia e Prokurimit cilësohet se llogaritja e fondit limit është ...“bazuar në nevojën e institucionit për tonera, çmimet e tregut, kontratat e viteve të mëparshme”, bashkëlidhur procesverbalit të kësaj njësie nuk ka asnjë dokument që e vërteton këtë përlllogaritje të fondit limit. Veprim që bie në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2 c) “Anëtarët e komisionit testojnë tregun për të marrë tregues për



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

çmimet e punëve, mallrave ose të shërbimeve, të cilat i pasqyrojnë në një procesverbal të mbajtur dhe të nënshkruar nga të tre anëtarët...". Një kërkesë e tillë është parashikuar dhe me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 59, pika 2, "Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dh c) çmimet ndërkombëtare, të botuara". Ky fakt tregon për pakujdesi në dokumentimin e llogaritjes së fondit limit, për të cilën mban përgjegjësi Njësia e Prokurimit.

#### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Nga ILDKPKI të merren masat, që në të gjitha procedurat e prokurimit të argumentojë nëpërmjet dokumentimit përlllogaritjen e fondit limit në përputhje me dispozitat ligjore të prokurimit publik, duke plotësuar gjurmën e auditit në dosjen e prokurimeve të realizuara, si nevojë për rritjen e transparencës dhe krijimit të gjurmës audituese.

#### **Përgjigja e institucionit:**

Institucioni sipas rekomandimit tuaj, menjëherë në mbështetje të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", për të gjitha llojet procedurave të prokurimit ka dokumentuar llogaritjen e fondit limit, nëpërmjet procesverbaleve të mbajtur dhe të nënshkruar nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit në mbështetje të llogaritjes së vlerës mesatare të testeve të çmimeve të tregut dhe të dokumentuara me oferta fizike nga operatorët ekonomikë.

Institucioni ynë ju informon se menjëherë me Urdhër nr. 1580, datë 28.7.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm "Për gjurmët standarte të auditit në ILDKPKI", janë miratuar gjurmët standarte të auditit ndërmjet të cilave për;

- Prokurimin e fondeve publike me vlerë mbi 800 mijë lekë.
- Prokurimin për blerje të vogla.

#### **Komenti i grupit të auditimit**

Dokumentacioni i paraqitur në përgjigjen e subjektit është bashkëlidhur përgjigjes në lidhje me këtë rekomandim.

*Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i zbatuar plotësisht.*

4. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Blerje materiale pastrimi" konstatoam se në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dhe dokumentacionit bashkangjitur praktikës së likuidimit, ka një mospërputhje midis fituesit në sistemin elektronik (shoqëria "Nirupa" sh.p.k), dhe përfituesit të pagesës që është personi fizik Vasiliqi Rusmali, i cili është renditur i katërti në sistem. NJP është mjaftuar vetëm me lajmërimin elektronik në rastet e tërheqjes nga oferta të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës që rezultojnë fitues. Ky veprim bie në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 5, datë 27.01.2015 "Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit Elektronik" ku citohet "Kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij, ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave tek dritarja e njoftim fituesit, me anë të lupës duhet të përzgjedhë operatorin e dytë të klasifikuar në listë duhet të plotësoni subjektin "Njoftim fituesi", në hapësirën "Përshkrim" duhet të jepni një përshkrim të shkurtër dhe më pas bashkëlidhni dokumentin e njoftimit të fituesit duke klikuar tek opsioni "Bashkëlidh dokumentin". Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të njoftojë ofertuesin e renditur në vend të dytë edhe nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve), mbi klasifikimin e ri të procedurës. Autoriteti kontraktor duhet të ndjekë të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

njëjtët hapa në rast se kalon te ofertuesi i renditur në vend të tretë e kështu me radhë deri te ofertuesi i renditur në vend të pestë”.

### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Nga ILDKPKI në çdo rast kur ka ri-klasifikim të operatorëve ekonomikë fitues në procedurat e prokurimit, të merren masat që në zbatim të legjislacionit të Prokurimit Publik, të bëhet pasqyrimi në sistemin elektronik.

### **Përgjigja e institucionit:**

Inspektorati i Lartë menjëherë, në çdo rast kur ka ri-klasifikim të operatorëve ekonomikë fitues në procedurat e prokurimit të realizuara, ka marrë masat në zbatim të legjislacionit të Prokurimit Publik, të kryejë pasqyrimin e këtij ri-klasifikimi në sistemin elektronik.

### **Komenti i grupit të auditimit**

Dokumentacioni i paraqitur në përgjigjen e subjektit është bashkëlidhur përgjigjes në lidhje me këtë rekomandim.

*Për sa me sipër ky rekomandim konsiderohet i zbatuar plotësisht.*

5. Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt “Pjesë Këmbimi automjete” konstatoam se në inventarin e brendshëm të dosjes me nr. 4879/1, datë 10.11.2014, ndodhej dokumentacioni i tenderit me objekt “Riparimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve të ILDKPKI-së”. Nga ana tjetër vlerësimi i kritereve të veçanta të vendosura nga njësia e prokurimit tregon se ka kërkesa, të cilat nuk janë relevante për objektin që është në prokurim. Kështu konstatojmë se për procedurën “Riparimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve të ILDKPKI-së” është kërkuar që operatori ekonomik ofertues të vërtetojë se ka në përbërje të servisit repartet si vijon:

- ura ngritëse për automjete, copë 4 (katër), ndërkohë që objekt i prokurimit janë vetëm dy automjete.

Ndërkohë që për procedurën “Riparimin e pjesëve të këmbimit”, njësia e prokurimit ka kërkuar që operatori ekonomik pjesëmarrës tek “Kapaciteti teknik”, të ketë minimumi 10 punonjës, inxhinier mekanik (një), elektroaut (një), motorist (një), xhenerik (dy), bojaxhi (një), llamarinist (një)”. Kërkesa që janë të tepërta kur flitet për riparim pjesë këmbimi. Nga ana tjetër kërkesa si aparat saldimit me oksigjen- aparat saldimit me argon - urë kaliber për tërheqje shasie- furrë për pjekje boje dhe të gjitha pajisjet e tjera ndihmëse, kritere të papërshtatshëm me këtë objekt prokurimi.

### **Për sa më sipër rekomandoj:**

Nga njësia e prokurimit të ILDKPKI të merren masat që në çdo rast të procedurave të prokurimeve, kërkesat për kualifikim të hartojë me kujdes të plotë, duke u referuar vetëm në nevojat e objektit të prokurimit, bazuar në legjislacionin e Prokurimit Publik.

### **Përgjigja e institucionit**

Zbatimin menjëherë të rekomandimit të lënë në lidhje me zbatimin e procedurave ligjore në prokurimin e fondeve publike, për hartimin nga njësia e prokurimit të ILDKPKI, me përgjegjësi të plotë të kërkesave për kualifikim, vetëm në nevojat e objektit të prokurimit dhe bazuar në legjislacionin e Prokurimit Publik e dokumentuar në praktikafat në vijim të prokurimeve të realizuara për tendera të ngjashëm me atë të zhvilluar në konstatimin e KLSH-së.

### **Komenti i grupit të auditivit**

Dokumentacioni i paraqitur në përgjigjen e subjektit është bashkëlidhur përgjigjes në lidhje me këtë rekomandim.

*Për sa me sipër ky rekomandim konsiderohet i zbatuar plotësisht.*



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

### 3. TË TJERA QË REZULTOJNË GJATË AUDITIMIT

#### Prokurimet e fondeve publike

- a. Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik.
- b. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave punëve dhe shërbimeve.

Gjatë auditimit, mbi procedurat e prokurimeve të realizuara në ILDKPKI, përgjatë viteve të audituara, 2017 deri në 31.03.2018, në bazë të bazës të Programit të Auditimit, grupi i audituesve të KLSH-së, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore ligji nr. 9646 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", VKM nr. 918 datë 29.12.2014 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike", Udhëzim e APP-së nr. 2 datë 27.01.2015 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik", Udhëzimin e APP-së nr. 3 datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël" dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Në bazë të regjistrave të parashikimit dhe ato të realizimit të cilat janë paraqitur brenda fateve sipas viteve buxhetore të dërguara pranë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) me nr. 62 prot datë 11.01.2017 (Regjistri i Parashikimit të Prokurimeve Publike për vitin 2017 për Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ) si dhe me shkresë nr. 151/1 prot me datë 15.01.2018 "Regjistri i realizimit të prokurimeve publike për vitin 2017"; ndërsa për vitin 2018 regjistri i parashikimit është dërguar online pranë APP-së, në bazë të ndryshimeve të pësuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 4 dhe neni 7/2, i ndryshuar.

Grupi auditimit, konstatoi se pranë ILDKPKI-së, janë kryer procedura tenderuese kryesisht në zërin buxhetor 231 (kryesisht pajisje kompjuterike dhe elektronike) dhe 602 (mallra), për rrjedhojë vendosi auditimin e disa prej procedurave, duke i përzgjedhur me metoda me zgjedhje rastësore, metoda e gjurmimit të dokumentacionit si dhe çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjës për procesin e prokurimit të audituar. Përqendrimi i grupit të auditimit është mbështetur në pikat e renditura të audituara si më poshtë:

- Hartimin dhe njoftimin e regjistrit të prokurimit publik;
- Llogaritjen e fondit limit dhe procedurat e shpalljes së prokurimit;
- Hartimi i kërkesave për kualifikim, miratimi i dokumenteve standarte të tenderit;
- Paraqitja dhe shqyrtimi i ofertave;
- Vlerësimi i ofertave dhe klasifikimi i ofertuesve, verifikimi në sistemin prokurimit elektronik (SPE);
- Menaxhimi i procesit të ankimit, pjesëmarrësit në proces;
- Njoftimi, hartimi dhe nënshkrimi i kontratës me operatorin fitues dhe zbatimi i saj.
- Zbatimi dhe monitorimi i kontratës.

Nga auditimi u konstatua, se procedurat tenderuese për periudhën e audituar janë zhvilluar në bazë të urdhrave administrative të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor (i deleguar) pranë ILDKPKI-së, si vijon:

- Urdhër nr.3 datë 04.01.2017 "Për delegim kompetencash" në bazë të nenit 28, të ligjit nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "për prokurim publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik".

Për prokurimet e fondeve publike të miratuara në ligjin nr. 130, datë 15.12.2016, "Për buxhetin e vitit 2017", ti delegohen kompetencat e titullarit të Autoritetit Kontraktor për



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË “INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE”

Inspektoratin e Lartë të deklarimit dhe kontrollit të Pasurive dhe konfliktit të interesave, sekretarit të përgjithshëm, znj. Kozeta Ndoi.

- Urdhër nr. 1, datë 03.01.2018 “për delegim kompetencash”, për prokurimin e fondeve publike të miratuara në ligjin 109/2017, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, të delegohen kompetencat e titullarit të Autoritetit Kontraktor për Inspektoratin e lartë të deklarimit dhe Kontrollit të pasurive dhe Konfliktit të Interesave, znj. Kozeta Ndoi.

- Urdhër nr. 5 datë 04.01.2017 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2017”, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe Urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 3, datë 04.01.2016 “Për delegim kompetencash” për administrimin e vazhdueshëm të prokurimeve të ILDKPKI-së, për fondet buxhetore të miratuara për vitin 2017.

- Urdhër nr. 9, datë 04.1.2018 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2018” në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe Urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 1, datë 03.01.2018 “Për delegim kompetencash” për administrimin e vazhdueshëm të prokurimeve të ILDKPKI-së, për fondet buxhetore të miratuara për vitin 2018.

- Urdhër nr. 10, datë 04.01.2018 “Për ngritjen e njësisë së prokurimit publik për vitin 2018.”

- Urdhër nr. 4, datë 04.01.2017 “Për ngritjen e njësisë së prokurimit publik për vitin 2017”.

Kështu sa më sipër, për vitin 2017, nga auditimi u konstatua se, nga fondi limit total prej 14,234,220 lekë pa tvsh, i vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit janë zhvilluar 34 procedura prokurimi, (nga të cilat 5 kërkesë me propozim, 1 procedurë me negociim pa shpallje paraprake dhe 28 me vlerë të vogël), të cilat janë përlllogaritur në vlerë kontrate të realizuara prej 13,339,250 lekë me TVSH.

Për periudhën 8 mujorin e vitit 2018, nga auditimi u konstatua se nga fondi limit total prej 10,136,819 lekë pa TVSH, i vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit janë zhvilluar 15 procedura prokurimi (1 procedurë me negociim pa shpallje paraprake, 4 procedura kërkesë për propozim dhe 10 procedura me vlerë të vogël), të cilat janë përlllogaritur në vlerë kontrate të realizuara prej 10,867,274 lekë me TVSH.

Grupi i auditimit, për vitin 2017, auditoi 2 **procedura** me llojin e procedurës “Kërkesë për propozim” me vlerë totale 2,500,000 lekë pa tvsh dhe 28 procedura me vlerë të vogël me vlerë totale 6,507,617 lekë pa tvsh. Pra në total, grupi i auditoi 30 procedura prokuruese me vlerë prej 9,007,617, lekë pa tvsh, të cilat zënë 63.2 % të vlerës së prokuruar për vitin buxhetor 2017.

Grupi i auditimit, për 8 mujorin e vitit 2018, auditoi 2 **procedura** me llojin e procedurës “Kërkesë për propozim” me vlerë totale 2,500,000 lekë pa tvsh dhe 10 procedura me vlerë të vogël me vlerë totale 2,731,127, lekë pa tvsh. Pra në total, grupi i auditoi 12 procedura prokuruese me vlerë prej 5,231,127 lekë pa tvsh, të cilat zënë 51.6 % të vlerës së prokuruar për vitin buxhetor 2018.

Nga auditimi i tyre, u konstatua se janë realizuar në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore. Në të gjitha procedurat e audituara duke i verifikuar si në dosjen fizike dhe në sistemin e prokurimit elektronik, u evidentua se, ka fituar operatori ekonomik me çmimin më të ulët dhe nuk ka pasur ankesa, në lidhje mbi vendosjen e kriterëve specifike kualifikuese nga ana e Njësisë së Prokurimit, në drejtimin e shqyrtimit të ofertave si dhe në klasifikimin e ofertuesve nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

Procedurat prokuruese të audituara për vitin 2017 dhe periudha deri në 31.08.2018, rezultuan në përputhje me ligji nr. 9646 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe çdo akti normativ nënligjor të fushës, janë si më poshtë:

- 1). Procedura e prokurimit me objekt "Blerje e Pajisje Teknike për dhomën e Serverit" viti 2017.
- 2). Procedura e prokurimit me objekt "Blerje pajisje dhe kompjuterike dhe elektronike" viti 2017.
- 3). Procedura e prokurimit me objekt "Blerje pajisje dhe kompjuterike dhe elektronike" viti 2018.
- 4). Procedura e prokurimit me objekt "Blerje kondicionier profesional" viti 2018.

Të dhëna të përgjithshme të procedurës

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Blerje Pajisje Teknike per Dhomen e Serverit		
1. Urdhër Prokurimi Nr.2968 prot, datë 29.6.2017	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit, specifikimet teknike, kohezgjatja e kontrates, etj janë nga realizuar nga njesia e prokurimit	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Kërkesë për propozim"	Urdhër Nr. 121, dt.23.6.2017 është përcaktuar Njësia e Prokurimit, me përbërje 1)Arber Basholli /jurist 2)Ardita Kraja/ekonomiste 3)Erarsi Daberdaku/ jurist 4) Daniel Abasllari / Inxhinier Elektronik	Urdhër Nr. 2976 Prot, datë 3.7.2017 Erion Pjetri (Kryetar) Albana Ramaliu (Anëtare) Elvira Daberdaku (Anëtare)
5. Fondi Limit (pa tvsh) 1,241,667 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese (pa tvsh) 1,142,000 leke pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 99,667 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Date 10.7.2017	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender2 (dy) -OE b)S'kualifikuar 1 (nje) OE, c) Kualifikuar 1 (nje) OE,
11. Ankimime AK-nuk ka pasur ankimime	12. Përgjigje Ankesës nga AK	
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr.3275 prot datë 31.7.2017 lidhur me OE fitues "Sinapse ATS" sh.p.k	15. Vlera e kontratës (me tvsh) Vlera e kontrates shtese 1,370,400 lekë me tvsh	16. Likuiduar deri sipas urdher shpenzimit; UXH nr. 149, dt14.9.2017 me vlerë prej 1,370,400 lekë. me tvsh
17. Afati i kontratës në dite Parashikuar 15 ditë	18. Akt i marrjes në dorëzim Procesverbali i datës 14.8.2017	19. Fletë Hyrja dorezimi i mallit sipas FH. Nr.11, date 14.8.2018

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Blerje Pajisje Kompjuterike dhe Elektronike		
1. Urdhër Prokurimi Nr.901 prot, datë 15.3.2017	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit, specifikimet teknike, kohezgjatja e kontrates, etj janë nga realizuar nga njesia e prokurimit	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

	Urdhër Nr. 4, dt.4.1.2017 është përcaktuar Njësia e Prokurimit, me përbërje	Urdhër Nr. 901/2 Prot, datë 28.3.2017
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Kërkesë për propozim"	1)Arber Basholli /jurist 2)Ardita Kraja/ekonomiste 3)Jonida Cekrezi spec/Shkenca kompjuterike	Erion Pjetri (Kryetar) Flora Beqiraj (Anëtar) Erion Kokonozi (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa tvsh) 1, 258,333 lekë pa tvsh	6. Oferta fituese (pa tvsh) 1,189,990 leke pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 68,343 lekë
8. Data e hapjes së tenderit datë 4.04.2017	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 5 (pese) -OE b)S'kualifikuar 3 (tre) OE, c) Kualifikuar2 (dy) OE,
11. Ankimime AK-nuk ka pasur ankimime	12. Përgjigje Ankesës nga AK	
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr.1641 prot datë 28.4.2017 lidhur me OE fitues "BNT Electronics" sh.p.k	15.Vlera e kontratës (me tvsh) Vlera e kontrates shtese 1,427,988 lekë me tvsh	16. Likuiduar deri sipas urdher shpenzimit; 1- nr. 88, dt.6.6.2017 me vlerë prej 1,427,988 lekë. me tvsh
17. Afati i kontratës në dite Parashikuar 10 ditë	18. Akt i marrjes në dorëzim Procesverbali i datës 8.5.2017	19. Fletë Hyrja dorezimi i mallit sipas FH. Nr. 3, date 8.5.2017

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Blerje Pajisje Kompjuterike dhe Elektronike		
1. Urdher Prokurimi, nr. 677 prot, date 5.2.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit, specifikimet teknike, kohezgjatja e kontrates, etj janë nga realizuar nga njesia e prokurimit Urdhër Nr. 37, dt.1.2.2018 është përcaktuar Njësia e Prokurimit, me përbërje	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 697 Prot, datë 7.2.2018
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Kërkesë për propozim"	1)Arber Basholli /jurist 2)Ardita Kraja/ekonomiste 3)Algert Shevroja spec/Shkenca informatike 4) Erardi Daberdaku/Jurist	Flora Beqiraj (Kryetar) Elvira Daberdaku (Anëtar) Erion Pjetri (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa tvsh) 1,250,000 lekë pa tvsh	6. Oferta fituese (pa tvsh) 988,900 leke pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 261,100 lekë
8. Data e hapjes së tenderit datë 19.2.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 6 (gjashte) - OE b)S'kualifikuar 4 (kater) OE, c) Kualifikuar 2 (dy) OE,
11. Ankimime AK-nuk ka pasur ankimime	12. Përgjigje Ankesës nga AK	





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË “INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE”

b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës	15. Vlera e kontratës (me tvsh)	16. Likuiduar deri sipas urdher shpenzimit;
Nr.1233 prot datë 9.3.2018 lidhur me OE fitues “BNT Electronics” sh.p.k	Vlera e kontrates shtese 1,186,680 lekë me tvsh	1- nr. 58, dt.18.4.2018 me vlerë prej 1,186,680 lekë. me tvsh
17. Afati i kontratës në dite Parashikuar 10 dite	18. Akt i marrjes në dorëzim Procesverbali i datës 16.3.2018	19. Fletë Hyrja dorezimi i mallit sipas FH. Nr.3, date 16.3.2018

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Blerje Kondicioner Profesional me Precizion të Lartë		
1. Urdhër Prokurimi Nr.2419 prot, datë 22.5.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit, specifikimet teknike, kohezgjatja e kontrates, etj janë nga realizuar nga njesia e prokurimit Urdhër Nr. 2180 prot dt.18.5.2018 është përcaktuar Njësia e Prokurimit, me përbërje	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 2418 Prot, datë 22.5.2018
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Kërkesë për propozim"	1)Arber Basholli /jurist- Kryetar 2)Ardita Kraja/ekonomiste 3)Erarsi Daberdaku/ jurist 4) Daniel Abasllari / Inxhinier Elektronik	Erion Pjetri (Kryetar) Majlinda Thomaj (Anëtar) Astrit Iljazi (Anëtar)
5. Fondi Limit (pa tvsh) 1, 250,000 lekë pa tvsh	6. Oferta fituese (pa tvsh) 1,150,000 leke pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 100,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit datë 4.06.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 3 tre -OE b)S'kualifikuar 2 (dy) OE, c) Kualifikuar 1 (nje) OE,
11. Ankimime AK- ka pasur ankimime Nr.2732 Prot, date 18.6.2018	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr.2732/1, date 20.6.2018	13. Nu ka ankimim ne KPP

b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës	15. Vlera e kontratës (me tvsh)	16. Likuiduar deri sipas urdher shpenzimit;
Nr.2904 prot datë 20.7.2018 lidhur me OE fitues “Synapse ATS” sh.p.k	Vlera e kontrates shtese 1,380,000 lekë me tvsh	1- nr.156, dt.18.9.2018 me vlerë prej 1,380,000 lekë. me tvsh
17. Afati i kontratës në dite Parashikuar 30 dite	18. Akt i marrjes në dorëzim Procesverbali i datës 8.5.2017	19. Fletë Hyrja dorezimi i mallit sipas FH. Nr.12, date 17.8.2018

#### D. GJETJET NGA AUDITIMI, IMPAKTI TE PASQYRAT FINANCIARE DHE REKOMANDIMET PËRKATËSE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të pasqyrave financiare ka rezultuar se shuma prej 12,000 lekë e regjistruar në debi të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në kundërshtim me udhëzimin nr. 14, datë 28.02.2006 “Për përgatitjen dhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### ROPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN FINANCIAR NË "INSPEKTORATIN E LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE"

raportimin e pasqyrave financiare vjetore" dhe udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Në rastin në fjalë nëse do të kishim të bënim me një shpenzim të periudhave të ardhshme, nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura do të bëhej si më poshtë:  
- Debitohet llogaria përkatëse 486, "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura"; dhe - Kreditohet llogaria përkatëse 467, "Kreditorë të ndryshëm". Në këtë rast vlera 12,000 lekë nuk është shpenzim, por është vlerë e arkëtuar tepër nga një zyrë përmbarimore, e cila do të kthehet subjektin në periudhën e ardhshme buxhetore.

*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 8-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

#### Rekomandojmë:

Nëpunësi zbatues të marra masa për sistemimin e llogarive në pasqyrën financiare të vitit 2017, ku në mbyllje të vitit ushtrimor, debia e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" duhet të ishte pasqyruar në shumën 12,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën e mjeteve në ruajtje në kredi të llogarisë 466.

Njësia e cila trashëgon të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e pasqyrës së pozicionit financiar.

*Menjëherë*

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

## KONTROLLI I LARTË SHTETIT

1. Valentina Golemi, Përgjegjësi i Grupit të Auditimit
2. Joniada Goçaj
3. Aldo Kume

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

Bashkim Arizaj